

**SHENJAT PARA  
DITËS SË  
GJYKIMIT**

IMAM IBN KETHIRI

# SHENJAT PARA DITËS SË GJYKIMIT

Imam Ibn Kethir

## Ajetet dhe hadithet rreth Çastit

Allahu i lartësuar ka thënë:

« Të pyesin rreth Çastit: ‘Kur e ka kohën?’ Çfarë rëndësie ka për ty që ta përmendësh atë? Te Zoti yt është afati i tij. Ti nuk je veçse një paralajmërues për ata që ia kanë frikën atij [Çastit]? Ditën kur do ta shohin atë, do t’u duket sikur të kenë qëndruar veç një mbrëmje apo një mëngjes » [en-Naziat, 42-46]

« Të pyesin ty rreth Çastit: ‘Kur e ka kohën?’ Thuaj: ‘Vetëm Zoti e di dhe askush s’mund të thotë se kur do të ndodhë ai. E rëndë do të jetë për qiejt dhe për tokën dhe do të vjen papritmas.’ Ty pyesin ty thua se ti e di këtë mirë. Thuaj: ‘Vetëm Zoti e di, por shumica e njerëzve nuk e dinë këtë’ » [el-A’raf, 187]

Ka shumë ajete e hadithe lidhur me këtë temë. Allahu i lartësuar ka thënë:

« Çasti është afruar dhe hëna është çarë » [el-Kamer, 1]

Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] tha ndërsa tregonte me gishtin tregues dhe me gishtin e mesëm:

“Ardhja ime dhe Çasti janë si këta dy gishtërinj”.

Në një hadith tjetër, tha:

“Çasti gati sa nuk erdhi para meje”.

Kjo tregon se sa relativisht afër Çastit jemi.

Allahu i lartësuar ka thënë:

« I është afruar njerëzimit Dita e Llogarisë, megjithëkëtë ata kthejnë shpinën dhe janë të shkujdesur » [el-Enbija, 1]

« Urdhri [Çasti] i Allahut do të ndodhë, kështu që mos kërko ngutjen e tij » [en-Nahl, 1]

**« Ata që s'besojnë, kërkojnë ngutjen e tij; ata që besojnë, ia kanë frikën dhe e dinë se është përnjëmend » [esh-Shura, 18]**

Në *Sahih el-Buhari*, gjendet një hadith ku thuhet se një beduin e pyeti peygamberin rreth Çastit. Ai [salallahu alejhi ue selam] tha:

- Sigurisht që të ndodhë. Çka ke përgatitur për të?
- O i Dërguar i Allahut, s'kam falur shumë namaz e s'kam shumë punë të mira, por e dua Allahun dhe të Dërguarin e Tij.
- Ti do të jesh me ata që i do.

Muslimanët kurrë s'janë gëzuar më shumë sesa kur kanë dëgjuar këtë hadith.

Disa hadithe tregojnë se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] qe pyetur rreth Çastit dhe ai shikoi nga një djalosh dhe tha:

**“Nëse ai jeton, s'do të plakët shumë para se ta shohë Çastin të ndodhë”.**

Me këtë, ai mendoi në vdekjen e tyre dhe kalimin në ahiret [jetën e përtejme], sepse gjithkush që vdes, kalon në ahiret. Disa thonë se, kur personi vdes, Gjykimi i tij vetëm se ka nisur. Ky hadith me këtë domethënie është *sahih* [i vërtetë]. Disa heretikë e komentojnë gabimisht këtë hadith. Kohën e saktë të Çastit të madh e di vetëm Allahu dhe këtë askujt nuk ia ka zbuluar, siç na bëhet e qartë nga hadithi ku peygamberi thotë:

**“Pesë gjëra s'i di kush, përveç Allahut”,** pastaj lexoi:

**« Vërtet, vetëm Allahu e di kur do të ndodhë Çasti. Ai e zbret shiun dhe e di se çfarë ka në mitra. Kurrkush s'e di çka do të fitojë të nesërmen e as që di dikush se në cilin vend do të vdesë. Vërtet, Allahu është i gjithëdijshëm, i mirinformuar [për gjithçka] » [Lukman, 34]**

Kur Xhibrili [alejhi selam] erdhi te peygamberi [salallahu alejhi ue selam] në formën e një beduini, ai e pyeti rreth Islamit, *imanit* [besimit] dhe *ihsanit* [shkallës më të lartë të besimit] dhe peygamberi iu përgjigj. Por, kur ai e pyeti rreth Çastit, ai tha: **“I pyeturi s'di gjë më shumë sesa pyetësi”**. Xhibrili tha: **“Më fol për shenjat e tij”**. Pastaj peygamberi i përshkroi ato, siç do t'i shohim më vonë, kur ta citojmë plotësisht këtë hadith dhe të tjerët.

Hudhejfe tha:

**“Peygamberi u çua e na foli një ditë dhe na tregoi gjithçka që do të ndodhë deri te Çasti dhe s'la gjë pa treguar. Disa nga ata që e dëgjuan, e mësuan përmendsh; disa e harruan. Këta shokë të mi e mësuan. Mua nuk më kujtohet krejtësisht, por**

nganjëherë më vjen ndër mend ashtu siç dikush do ta kujtonte dhe njihte fytyrën e një njeriu që e kishte harruar, kur ta shohë atë”. [Ebu Daud, Muslim]

Imam Ahmed transmetoi nëpërmjet Ebu Nudreh se Ebu Se'id tha:

“Një ditë prej ditësh, peygamberi na e fali namazin e ikindisë, pastaj u çua e na foli deri në aksham. Ai përmendi gjithçka që do të ndodhë deri në Ditën e Ringjalljes dhe s’la gjë pa treguar. Disa prej nesh e mbajtën në mend, disa e harruan. Ndër ato që tha ishte:

‘O njerëz, kjo botë është përplot joshje. Allahu ju ka caktuar si mëkëmbës në këtë botë dhe Ai do t’ju shohë se si po veproni, kështu që ruhuni nga joshjet e kësaj bote dhe ruhuni gruas’.

Nga fundi fjalimit tha:

‘Dielli gati sa nuk ka perënduar dhe çfarë ka mbetur nga kjo botë, krahasuar me atë që ka kaluar, është sikurse çfarë ka mbetur nga kjo ditë krahasuar me atë që ka kaluar’.

Ali ibn Zejd ibn Xhed'en el-Timi ka transmetuar disa hadithe *garib*<sup>1</sup> dhe *munker*<sup>2</sup>, çka do ta bënte të diskutueshëm vlefshmërinë e këtij hadithi. Por, ka disa transmetime që janë të ngjashme me këtë hadith dhe janë transmetuar me zinxhirë [*isnad*] tjetër. Një pjesë e këtij hadithi gjendet në *Sahih Muslim*, nëpërmjet Ebu Nudreh nga Ebu Se'id. Ky hadith i referohet asaj për të cilën s’ka dyshim: çka mbetet nga kjo botë, krahasuar me atë që ka kaluar, është shumë pak. Pavarësisht kësaj, kurrkush s’mund të dijë saktësisht sa kohë ka mbetur, përveç Allahut, dhe kurrkush s’e di saktë se sa kohë ka kaluar, përveç Allahut.

<sup>1</sup> Shënim: Hadith *gharib* është ai, që transmetohet vetëm nga një transmetues [*Nuz'heh el-Nether* nga Ibn Haxher el-Eskelani].

<sup>2</sup> Shënim: Sipas Ibn Haxher, nëse një transmetim që kundërshton një tjetër hadith autentik transmetohet nga një transmetues i dobët, ai njihet si *munker*.

## Përshkrim i përgjithshëm i Fitneve [Çrregullimeve]

Hudhejfe ibn el-Jeman ka thënë:

“Njerëzit e pyetnin pejgamberin [salallahu alejhi ue selam] rreth gjërave të mira, por unë e pyesja rreth gjërave të këqija, sepse tutesha se mos po më kaplonin. Thashë:

- O i Dërguar i Allahut, ne ishim të humbur në injorancë dhe ligësi, pastaj Allahu e pruri këtë të mirë [Islamin]. A do të vjen ndonjë e keqe mbas kësaj të mire?
- Po -, tha ai.
- A do të ketë mirësi mbas asaj të keqeje?
- Po, por do të jetë e njollosur me të keqe.
- Si do të jetë kjo njollosje?
- Do të ketë njerëz që do t'i udhëzojnë të tjerët në rrugë të ndryshme nga e imja. Ju do të shihni në ta si të mira, ashtu edhe të këqija.
- A do të vjen ndonjë e keqe mbas asaj mirësie?
- Disa njerëz do të çohen e do të thërrasin tek portat e xhehenemit. Kushdo që i përgjigjet thirrjes së tyre, do ta hedhin në Zjarr.
- O i Dërguar i Allahut, na i përshkruaj ata.
- Ata do të jenë nga populli jonë dhe do ta flasin gjuhën tonë.
- Çka më këshillon të bëj, nëse e përjetoj këtë.
- Mbahu me xhematin e muslimanëve dhe me udhëheqësin [imamin] e tyre.
- Çka nëse s'ka as xhemat e as udhëheqës.
- Izolohu nga krejt këto grupe, edhe nëse të duhet të hash rrënjët e pemës, derisa të të vjen vdekja ndërsa je në atë gjendje.

Abdullah ibn Mes'ud ka thënë: “Pejgamberi ka thënë:

‘Islami ka nisur si diçka i pazakontë dhe do të rikthehet si i pazakontë, ashtu siç ishte në fillim, kështu që përgëzime për të pazakonshmit’. Dikush pyeti: ‘Kush janë të pazakonshmit?’ Tha: ‘Ata që ndahen nga popujt [drejtpërdrejt: fiset] e tyre për hir të Islamit’”. [Ibn Maxheh nga Ebu Hurejre]

## Ndarjet brenda grupimit kryesor fetar

Ebu Hurejre ka transmetuar se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] tha:

“Çifutët u ndanë në 71 grupe, kurse umeti im do të ndahet në 72 grupe”.

Awf ibn Malik ka transmetuar nga Pejgamberi:

- Çifutët u ndanë në 71 grupe; një do të hyjë në xhenet, 70 do të hyjnë në xhehenem. Të krishterët u ndanë në 72 grupe; 71 do të hyjnë në xhehenem, një do të hyjë në xhenet. Pasha Atë, në Dorën e të cilit është shpirti im, umeti im do të ndahet në 73 grupe; një do të hyjë në xhenet, 72 do të hyjnë në Zjarr.
- Kush do të jenë ata [të shpëtuarit], o i Dërguar i Allahut? -, pyeti dikush.
- Xhemati -, u përgjigj ai. [Awf ibn Malik është i vetmi që e transmetoi këtë hadith dhe *isnadi* i tij është i pranueshëm].

Enes ibn Malik ka thënë: “Do t’ju tregoj një hadith që e kam dëgjuar nga i Dërguari i Allahut, të cilin s’do t’jua thotë kush mbas meje. E dëgjova të thotë:

“Ndër shenjat e Çastit do të jetë zhdukja e dijes [fetare] dhe shfaqja e injorancës. Kurvëria do të përhapet dhe pirja e verës [alkoolit] do të jetë e zakonshme. Numri i burrave do të zbresë, kurse numri i grave do të rritet, derisa një burrë të përkujdeset për pesëdhjetë gra”. [Ky hadith është transmetuar në dy *Sahi*-të nga hadithi i Abd Rabihi]

Abdullah tha: “Pejgamberi tha:

“Pak para Çastit, do të ketë ditë në të cilat dija [fetare] do të zhduket ndërsa injoranca do të shfaqet, dhe do të ketë vrasje të shumta”. [Ibn Maxheh. Po ashtu el-Buhari dhe Muslim nga hadithi i el-A’mesh]

Hudhejfeh ibn el-Jeman tha: “Pejgamberi tha:

- Islami do të shtirret ashtu siç shtirren teshat, derisa kurrkush të mos dijë për agjërimin, namazin e sadakanë. Kurani do të zhduket brenda një nate dhe asnjë ajet s’do të mbetet në tokë. Do të mbeten disa grupe nga të moçmit që do të thonë: ‘Kemi dëgjuar të parët të thonë *la ilahe ila Allah*, kështu që po e përsërisim dhe ne’.

Sileh e pyeti Hudhejfen:

- Çka do t’u bëjë punë *la ilahe ila Allah*, kur ata nuk dinë se çka është namazi, agjërimi dhe sadaka?

Hudhejfe e injoroi, por Sileh e përsëriti pyetjen tri herë dhe secilën herë Hudhejfe e injoroi, derisa në fund u përgjigj:

- O Sileh, do t’i shpëtojë nga Zjarri i xhehenemit -, dhe këtë e tha tri herë. [Ibn Maxheh]

Kjo tregon se në Ditët e fundit dija do t’u merret njerëzve, madje, edhe Kurani do të zhduket nga *mus’hafi* dhe nga zemrat e njerëzve. Njerëzit do të lihen pa dije. Vetëm të vjetrit do të thonë se kanë dëgjuar njerëzit të thonë *la ilahe ila Allah* dhe do ta përsërisin këtë për t’u ndjerë më afër Allahut. Kështu, kjo do t’u ofrojë disa bekime, edhe pse ata s’kanë punë të mira apo dije të dobishme. Dija do t’u merret njerëzve dhe injoranca do të

shtohet, dhe padituria dhe humbja e tyre do të shtohet vazhdimisht, deri në fund, si në hadithin e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam]:

“Çasti s’do t’i vjen dikujt që thotë ‘Allah, Allah’. Ai do t’ju vjen vetëm njerëzve më të këqij”.

## Të këqijat që do ta godasin umetin musliman gjatë Ditëve të fundit

Abdullah ibn Umer ka thënë: “Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] erdhi dhe tha:

“O Muhaxhirë [emigrantë nga Meka në Medinë], juve mund t’ju godasin pesë gjëra dhe Zoti mos e bëftë që t’i përjetoni ato. Nëse kurvëria përhapet, ju duhet ta dini se kjo kurrë s’ka ndodhur pa u rënë njerëzve sëmundje të reja, të cilat s’i kanë pasur paraardhësit e tyre.

Nëse njerëzit nisin të mashtrojnë në peshore, ju duhet të dini se kjo kurrë s’ka ndodhur pa i goditur njerëzit thatësia dhe uria, dhe pa u shtypur nga udhëheqësit e tyre.

Nëse njerëzit s’e japin zekatin, ju duhet të dini se kjo kurrë s’ka ndodhur pa pushuar shiu së rëni. Dhe po të mos ishte për kafshët, kurrë më s’do të binte shi.

Nëse njerëzit s’e respektojnë marrëveshjen me Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ju duhet ta dini që kjo kurrë s’ka ndodhur pa e dërguar Allahu një ushtri kundër tyre për të marrë pasurinë e tyre me zor.

Nëse udhëheqësit nuk qeverisin sipas Librit të Allahut, ju duhet ta dini se kjo kurrë s’ka ndodhur pa i ndarë Allahu ata në grupe që luftojnë njëra-tjetrën”. [Ibn Maxheh]

Ali ibn Talib ka thënë: “Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] ka thënë:

‘Nëse umeti im mbart pesëmbëdhjetë cilësi, do t’i godasin’ çrregullimet. Dikush pyeti: ‘Cilat janë ato, o i Dërguar i Allahut?’ Tha:

- Kur fitimi të shpërndahet vetëm midis të pasurve, pa u bërë dobi të varfërve.
- Kur besa të bëhet mjet për arritje të pasurisë.
- Kur zekati të bëhet barrë.
- Kur burri ta dëgjojë gruan dhe ta kundërshtojë nënën, dhe të sillet mirë me shokun ndërsa i shmanget babait.
- Kur të ngrihen zërat në xhami.
- Kur më i keqi i njerëzve të bëhet udhëheqës i tyre.

- Kur njerëzit ta respektojnë dikë nga frika e së keqes që ai mund të bëjë.
- Kur të pihet shumë verë [alkool].
- Kur burrat të mbartin mëndafsh.
- Kur të popullarizohen këngëtalet dhe instrumentet muzikore.
- Kur të fundit e këtij umeti të mallkojnë të parët e tij.

Atëherë, le të presin një erë të kuqe, apo që toka t'i përpijë, apo të transformohen në kafshë". [et-Tirmidhi]

Ali ibn Ebi Talib ka thënë: "Pejgamberi na udhëhoqi në namazin e sabahut. Kur e kreu, një burrë e thirri:

- Kur do të jetë Çasti?
- Hesht! -, i tha pejgamberi, dhe e qortoi.

Pas pak, ai i ngriti sytë nga qielli dhe tha:

- Lavdi Atij që e ngriti dhe u përkujdes për të.

Pastaj e uli shikimin për toke dhe tha:

- Lavdi Atij që e krijoi dhe e sheshoi. Ku është ai që më pyeti për Çastin?

Burri u gjunjëzua dhe tha:

- Unë isha që pyeta.
- Çasti do të vjen, kur udhëheqësit të jenë zullumqarë, kur njerëzit të besojnë në yje dhe ta mohojnë paracaktimin hyjnor [kaderin], kur besa të bëhet mjet për arritjen e pasurisë, kur njerëzit të ngurrojnë të japin sadaka, kur kurvëria të përhapet. Kur këto të ndodhin, atëherë populli yt do të mbarojë.

Imran ibn Husejn ka thënë: 'Pejgamberi tha:

- Disa njerëz nga umeti im do t'i përpijë toka, disa do të transformohen në kafshë dhe disave do t'ju bie rrebesh gurësh.
- Kur do të jetë kjo, o i Dërguar i Allahut -, pyeti një nga muslimanët.
- Kur të popullarizohen këngëtarët dhe instrumentet muzikore, dhe të pihet vera [alkooli] shumë. [et-Tirmidhi]



## Shenjat e mëdha të Çastit

Mbasi të shfaqen e të shtohen shenjat më të vogla të Çastit, njerëzimi do të ketë mbërritur një fazë të vuajtjeve të mëdha. Pastaj Mehdiu i prituri do të shfaqet. Ai është i pari nga shenjat e qarta e të mëdha të Çastit. Për ekzistencën e tij s' do të ketë dyshim, por kjo do t' u jetë e njohur vetëm atyre që dinë. Mehdi do të sundojë, derisa të shfaqet Mesia i rrejshëm [*el-Mesih el-Dexhxhal*], i cili do të përhapë zullum e çrregullime. Të vetmit që do ta njohin mirë dhe do t' i shmangen të keqes së tij, do të jenë ata që kanë dije e iman të madh.

Mesia i rrejshëm do të mbetet për një kohë, duke shkatërruar njerëzimin plotësisht, dhe toka do të dëshmojë *fitnen* [çrregullimin] më të madhe në historinë e saj. Pastaj Mesia Isa [alejhi selam] do të zbresë dhe do të sjellë drejtësi nga qielli. Ai do ta vrasë Dexhallin dhe do të ketë vjet sigurie.

Pastaj shfaqja e Jexhuxh e Mexhuxh do ta zë njerëzimin në befasi dhe çrregullimi do t' i kaplojë prapë ata. Në përgjigje të lutjes së Isës ndaj Allahut të lartësuar, ata do të vdesin dhe siguria, drejtësia e stabiliteti do të kthehen.

Kjo gjendje do të vazhdojë për disa vjet, deri në vdekjen e Isës. Dijetarët dallojnë rreth renditjes me të cilën do të shfaqen shenjat e mëdha të Çastit. Ato janë:

- Shkatërrimi i Qabes dhe zbulimi i thesarit të saj
- Lindja e diellit në perëndim
- Shfaqja e Bishës nga toka
- Tymi
- Një erë që do t' i marrë shpirtrat e besimtarëve
- Ngritja e Kuranit në qiell
- Një zjarr që do t' i shtyjë njerëzit për tek vendi përfundimtar i tubimit
- Fryrja në *Sur*. Në fryrjen e parë, gjithkush do të ndjejë tmerr. Në fryrjen e dytë, krejt do të vdesin. Dhe në fryrjen e tretë, krejt do të ringjallen.

## Mehdi

Mehdi do të vjen gjatë ditëve të fundit. Ai është një nga kalifët e udhëzuar drejt. Ai s' është Mehdi që pritet nga Shiat, për të cilin ata pohojnë se do të shfaqet nga një tunel në Samara. Ky pohim i tyre s' ka kurrfarë baze e as ndonjë burim të besueshëm. Ata pohojnë se emri i tij është Muhamed ibn el-Hasen ibn el-Eskeri dhe se ai kishte hyrë në

tunel, kur ishte pesë vjeç. Çështja të cilën ne synojmë ta shpjegojmë është provuar nga hadithe nga pejgamberi [salallahu alejhi ue selam]. Besoj që ai do të shfaqet para Isës, birit të Merjemes, siç tregojnë hadithet.

Haxhaxh tha se kishte dëgjuar Aliun të thotë se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Edhe sikur të mbetej vetëm një ditë për botën, Allahu do të dërgojë një njeri mes nesh, i cili do ta mbushë botën me drejtësi, mu siç ka qenë mbushur me zullum dhe padrejtësi”. [Ahmed]

Nga Ali se pejgamberi tha:

“Mehdi është një prej nesh, nga njerëzit e familjes sime. Brenda një nate, Allahu do ta frymëzojë atë dhe do ta përgatisë për të kryer punën e tij me sukses”. [Ahmed dhe Ibn Maxheh]

Ali tha ndërsa po shikonte të birin e tij, Hasanin: “Ky biri im është *sejjid* [zotëri], siç e ka quajtur edhe pejgamberi. Mes pasardhësve të tij do të jetë një njeri me emrin e pejgamberit tuaj. Ai do t’i përngjajë atij në sjellje, por jo edhe në pamje”. Pastaj ua përmendi faktin që toka do të mbushet me drejtësi. [Ebu Daud]

Ebu Daud i kushtoi një kapitull në *Sunenin* e tij temës së Mehdiut. Në fillim të kësaj kapitule, ai citon hadithin e Xhabir bin Samrah, ku pejgamberi thotë:

“Kjo fe do të mbetet e qëndrueshme, derisa mbi ju të sundojnë 12 kalifë”.

Në një transmetim tjetër, thuhet:

“Kjo fe do të mbetet e fortë, derisa mbi ju të sundojnë 12 kalifë”.

Xhabir tha: “Njerëzit u ngazëllyen dhe bërtitën *Allahu ekber!* Pastaj pejgamberi pëshpëriti diçka. E pyeta babën tim se çka tha dhe ai më tha: “Krejt ata [kalifët] do të jenë prej Kurejshëve”.

Në një tjetër transmetim, thuhet se, kur pejgamberi u kthye në shtëpi, Kurejshët erdhën dhe e pyetën: “Çka do të ndodhë pas kësaj?” Ai tha: “Pastaj do të ketë çrregullime e vrasje”.

Ebu Daud transmeton një hadith nga Abdullah ibn Mesud se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] tha:

“Nëse do të mbetesh vetëm një ditë nga kjo bote, ajo ditë do të zgjatet, derisa një burrë nga pasardhësit e mi - apo nga familja ime - të dërgohet. Emri i tij do të jetë si emri im dhe emri i babait të tij do të jetë si emri i babait tim. Ai do ta mbushë tokën me drejtësi, mu siç ka qenë e mbushur me zullum e padrejtësi. Bota nuk do të mbarojë, derisa të sundojë një burrë nga familja ime, emri i të cilit është si emri im”.

Abdullah [Ibn Mes’ud] tha se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Një burrë nga familja ime, emri i të cilit është si emri im, do ta marrë pushtetin”. [et-Tirmidhi].

Në një tjetër transmetim nga Ebu Hurejre, pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] tha:

“Sikur të mbetesh vetëm një ditë nga kjo botë, Allahu do ta zgjatë, derisa ai të marrë pushtetin”.

Ebu Seid tha se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Mehdi do të jetë nga pasardhësit e mi. Ai do të ketë ballë të lartë dhe hundën si grep [si sqepi i shqiponjës]. Ai do ta mbushë tokën me drejtësi, mu ashtu siç ka qenë mbushur me zullum e padrejtësi dhe do të sundojë për 7 vjet”. [Ebu Daud]

Umm Selemeh ka transmetuar se pejgamberi tha:

“Njerëzit do të nisin të përçahen mbas vdekjes së një kalifi. Një burrë nga banorët e Medinës do të ikë në Mekë. Disa banorë të Mekës do të vijnë te ai dhe do ta nxjerrin kundër dëshirës së tij. Ata do t’i zotohen për besnikëri atij mes *el-Rukn* dhe *el-Mekam* [te Qabja]. Një ushtri nga Siria do të dërgohet kundër tij, por do ta lëshojë toka në shkretëtirën mes Mekës dhe Medinës. Kur njerëzit ta shohin këtë, grupe njerëzish nga Siria dhe Iraku do të vijnë për t’iu zotuar për besnikëri. Pastaj një burrë nga Kurejshët, nëna e të cilit është nga Kelb, do të shfaqet dhe do të dërgojë një ushtri kundër tij, por ai do t’i mposhtë ata. Kjo do të njihet si beteja e Kelbit. Kushdo që do të mungojë në plaçkën e kësaj beteje, do të humbasë shumë! Mehdi do ta shpërndajë pasurinë dhe do të sundojë mbi njerëzit sipas Sunetit të pejgamberit. Pastaj ai do të vdesë dhe muslimanët do t’ia falin xhenazen”. [Ebu Daud]

Ali tha se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Një burrë me emrin el-Harith bin Hirath do të vjen nga Transoksania<sup>1</sup>. Ushtria e tij do të udhëhiqet nga një burrë i quajtur Mensur. Ai do ta trasojë rrugën për vendosjen e qeverisjes së familjes së Muhamedit, mu siç Kurejshët e vendosën qeverisjen e të Dërguarit të Allahut. Çdo besimtar do të jetë i obliguar ta mbështesë atë”. [Ebu Daud]

Abdullah in Harith ibn Xhuz el-Zubejdi tha se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Një popull do të trasojë rrugën për Mehdiun”. [Ibn Maxheh]

Abdullah tha: “Ndërsa ishim me peygamberin, disa të rinj nga Benu Hashim na u afruan. Kur peygamberi i pa ata, sytë e tij u mbushën me lot dhe ngjyra e fytyrës së tij ndryshoi. Thashë: ‘Shohim që diçka ta ndryshoi fytyrën dhe kjo po na shqetëson’. Peygamberi tha: ‘Ne jemi pjesëtarë të një familjeje për të cilën Allahu e ka zgjedhur ahiretin më parë sesa këtë botë. Pjesëtarët e familjes sime do të vuajnë shumë mbas vdekjes sime dhe do të persekutohen, derisa një popull që mbartin flamuj të zinj të vijnë nga lindja. Ata do t’i udhëzojnë njerëzit të bëjnë mirë, por njerëzit do të refuzojnë. Ata do të luftojnë, derisa të jenë fitimtarë dhe njerëzit të bëjnë ashtu siç u kërkojnë ata, por ata s’do ta pranojnë këtë prej tyre, derisa t’ia dorëzojnë pushtetin një burri nga familja ime. Pastaj toka do të mbushet me drejtësi, mu siç ka qenë mbushur me padrejtësi. Nëse dikush prej jush e përjeton këtë, ju duhet të shkoni te ai, edhe nëse ju duhet të zvarriteni nëpër akull”.

Ky tekst i referohet sundimit të Abasidëve, siç kemi përmendur në tekstin që i referohet nismës së sundimit të tyre më 132 H. Kjo, po ashtu, tregon se Mehdi do të shfaqet mbas Abasidëve dhe se ai do të jetë nga familja e peygamberit, pasardhës i Fatimes, bijës së peygamberit, nëpërmjet Hasanit e jo Husejnit, siç përmendet në hadithin nga Ali ibn Ebi Talib. Allahu e di më së miri.

Theuban tha se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Tre burra do të vriten në vendin ku gjendet thesari juaj. Secili prej syresh do të jetë bir i një kalifi dhe asnjëri prej tyre s’do të marrë thesarin. Pastaj flamujt e zinj do të vijnë nga lindja dhe do t’ju vrasin në një mënyrë të paparë”. Pastaj tha diçka që nuk më kujtohet. “Nëse e shihni atë, shkoni dhe zotojuni atij për besnikëri, edhe nëse ju duhet të zvarriteni mbi akull, sepse ai është kalifi i Allahut, Mehdi”. [Ibn Maxheh]

Thesaret e përmendura në tekst janë thesaret e Qabes. Nga fundi i kohës, tre bijë të kalifëve do të luftojnë për ta marrë atë, derisa të shfaqet Mehdi. Ai do të shfaqet nga lindja, jo nga tuneli i Samarës, siç thonë Shiat. Ata besojnë se ai tash gjendet në tunel dhe

<sup>1</sup> [SH.P] Emërtim i lashtë, i përdorur për pjesën e Azisë Qendrore, që përafërsisht i përgjigjet vendeve që sot njihen si Uzbekistan, Taxhikistan dhe Kazakistani jug-perëndimor.

ata e presin atë të shfaqet nga fundi i kohës. Për këtë s'ka dëshmi në ndonjë nga librat e koleksioneve të vërteta dhe s'ka dobi të besohet në këtë.

Fakti është se Mehdi, ardhja e të cilit është premtuar nga fundi i kohës, do të shfaqet nga lindja dhe njerëzit do t'i zotohen për besnikëri te Qabja, siç tregojnë disa hadithe. Në kohën e Mehdit, do të ketë paqe dhe prosperitet, pasuri me bollëk, pushtetarë të fortë dhe Islami do të jetë mirë i vendosur.

Ebu Seid tha: "Pasha Allahun, çdo sundues që kemi pasur, ka qenë më i keq se paraardhësi i tij dhe çdo vit ka qenë më i keq se viti paraprak. Mirëpo, dëgjova që peygamberi tha: 'Mes sunduesve tuaj do të jetë një që do të shpërndajë pasuri lirshëm, pa e llogaritur. Një burrë do të vjen dhe do t'i kërkojë para dhe ai do t'i japë. Burri do ta hapë pelerinën e tij dhe sunduesi do të derdhë para në të'. Peygamberi e hapi pelerinën e tij të trashë që po e mbartte për të demonstruar veprimin e atij burrit. Pastaj ai e mblodhi atë nga qoshtet e saj dhe tha: 'Pastaj burri do të marrë e do të largohet''. [Ahmed]

## Sprovat dhe çrregullimet

Zejneb bint Xhahsh tha: "Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] u zgjua nga gjumi me fytyrë të skuqur dhe tha:

- Kurrkush s'meriton të adhurohet, përveç Allahut. Mjerë arabët për një të keqe të madhe që po u afrohet atyre! Sot është bërë një çarje e këtillë [Sufjan e përshkroi çarjen me gishtërinj] në murin/pengesën e Xhuxhëve dhe Mexhuxhëve.
- A do të shkatërrohem, ndonëse mes nesh ka njerëz të mirë? – pyeti dikush.
- Po, nëse e keqja shtohet – u përgjigj pejgamberi. [el-Buhari]

Umm Selemeh, bashkëshortja e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] tha se një natë prej netësh pejgamberi u zgjua e tha:

"SubhanAllah! Sa shumë çrregullime zbritën sonte dhe sa shumë thesare u zbuluan! Shko dhe zgjoji banorët e këtij vendbanimi [dmth gratë e tij] që të falin namaz. Një shpirt që vishet mirë në dunja, mund të jetë i zhveshur në ahiret". [el-Buhari]

Usame bin Zejd tha: "Një ditë prej ditësh, pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] qëndroi mbi njërin nga muret mbrojtëse të Medinës dhe i pyeti njerëzit:

- A po shihni çfarë po shoh unë?
- Jo – ia kthyen ata.
- Po shoh vuajtje që bien në shtëpitë tuaja sikurse pikat e shiut. [el-Buhari, Muslim]

Ebu Hurejre [radi Allahu anhu] tha: "Pejgamberi tha:

- Koha do të kalojë shpejt, dija [fetare] do të pakësohet, koprracia do të përhapet në zemrat e njerëzve, fatkeqësitë do të shfaqen dhe do të ketë shumë *herxh*.
- O i Dërguar i Allahut, çka është *herxh*? – pyetën njerëzit.
- Vrasje! Vrasje! - tha ai. [el-Buhari]

Ebu Zubejr ibn Adi transmetoi: "Shkuam te Enes bin Malik dhe iu ankuam për padrejtësitë që po vuanim nga ana e el-Haxhxhaxh. Enes bin Malik tha: "Kini durim, se s' do të vjen ndonjë kohë veçse tjetra pas saj do të jetë më e keqe, derisa ta takoni Zotin tuaj. Dëgjova pejgamberin duke thënë këtë". [el-Buhari]

Ebu Hurejre tha: "Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] tha:

"Do të vjen një kohë fatkeqësish kur ai që rri ulur, do të jetë më i mirë se ai që qëndron në këmbë; ai që qëndron në këmbë, do të jetë më i mirë se ai që ecën; ai

që ecën, do të jetë më i mirë se ai që vrapon. Kushdo që u ekspozohet këtyre fatkeqësive, do të shkatërrohet prej tyre. Kështu, kushdo që gjen një vendstrehim, le të strehohet aty". [el-Buhari, Muslim]

Hudhejfe tha:

"Pejgamberi na i tregoi dy hadithe, njëren nga të cilat e kam parë të përmbushet ndërsa po pres për përmbushjen e tjetrit. Pejgamberi na tha se ndershmëria zbriti në zemrat e njerëzve [nga Allahu], pastaj ata e mësuan atë nga Kurani dhe më pas nga Suneti. Pejgamberi na tha se ndershmëria do të hiqet. Ai tha se njeriu do të kaplohet nga gjumi, gjatë të cilit do t'i hiqet ndershmëria nga zemra e tij dhe do të mbeten vetëm gjurmët e saj, si gjurmët e një pike të zezë. Pastaj njeriu do të kaplohet prapë nga gjumi, gjatë të cilit ndershmëria do të zvogëlohet edhe më shumë, derisa mbetjet e saj t'i përngajnë një fshike e cila shkaktohet nga një gacë që bie në këmbën e dikujt: ajo fryhet, por në brendësi s'ka kurrëgjë. Njerëzit do të vazhdojnë me tregtinë e tyre, por s'do të ketë njerëz të besueshëm. Njerëzit do të thonë: 'Është një burrë në filan fisin'. Më vonë do të thonë për një burrë: 'Sa i mençur, sa i sjellshëm dhe sa i fortë është ai!', ndonëse ai s'do të ketë besim as sa kokrra e hardallit në zemrën e tij. Vërtet, pat ardhur një kohë kur nuk e kisha problem të tregtoja me ndonjërin prej jush, sepse, nëse ai ishte musliman, Islami i tij e detyronte të më paguante çfarë më kishte borxh dhe, nëse ishte i krishterë, zyrtari musliman e detyronte të ma paguante borxhin. Por, tash nuk tregtoj me askënd, përveç me filanin e me filanin". [el-Buhari]

Ibn Umer tha: "Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] qëndroi pranë mimberit, duke qenë i drejtuar nga Lindja, dhe tha:

'Fatkeqësitë do të shfaqen nga kjo anë, ku do të shfaqet maja e kokës së Shejtanit". [el-Buhari]

Ebu Hurejre tha: "Dëgjova pejgamberin të thotë:

'Çasti nuk do të vjen, derisa të lëvizin kofshët e grave të Deusit rreth Dhul-Kheleseh'. Dhul-Kheleseh ishte një idhull që adhurohej nga fisi Deus gjatë xhahilijetit. [el-Buhari]

Ebu Hurejre, po ashtu, tha: "Pejgamberi tha:

'Eufrati do të zbulojë një thesar ari. Kushdo që të jetë i pranishëm në atë kohë, s'duhet të marrë ndonjë gjë prej tij".

Ebu Hurejre tha: "Pejgamberi tha:

‘Çasti s’do të vjen para se Eufirati të zbulojë një kodër me ar, për të cilin njerëzit do të luftojnë. Nëntëdhjetenëntë nga njëqind do të vdesin, por secili prej syresh do të mendojë se, ndoshta, ai do të mbijetojë [dhe ta marrë arin]’. [Muslim]

Ebu Hurejre tha se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Çasti s’do të vjen, derisa të ndodhin ngjarjet në vijim:

- Dy grupe të mëdha do ta luftojnë njëri-tjetrin dhe do të ketë shumë viktime, dhe të dyja këto grupe do të ndjekin mësimet e njëjta fetare
- Do të shfaqen tridhjetë Dexhallë, secili prej tyre duke pohuar rrejtshëm se është një i Dërguar nga Allahu
- Dija [fetare] do të zhduket
- Do të shtohen tërmetet
- Koha do të kalojë shpejt
- Do të shfaqen fatkeqësitë
- Do të shtohet vrasja
- Pasuria do të shtohet aq shumë, saqë i kamuri do të brengoset se mos nuk po ka kujt t’ia japë zekatin. Dhe, kur ia ofron atë dikujt, personi do t’i thotë së s’ka nevojë për të
- Njerëzit do të garojnë në ndërtimin e ndërtesave të larta
- Kur njeriu të kalojë pranë varrit të dikujt, do të thotë: ‘Sikur të isha në vendin e tij!
- Dielli do të lindë në Perëndim. Kur ai të lindë dhe njerëzit ta shohin këtë, do të besojnë, por « **Atëherë, besimi s’do t’i bëjë dobi asnjë shpirti, nëse s’ka besuar më herët dhe s’ka bërë punë të mira nga besimi i tij ...** » [el-En’am, 158]
- Çasti do të vjen papritmas. Një burrë do të mjetë devenë e vet dhe ta marrë qumështin, por s’do të ketë kohë ta pijë atë. Një burrë do të ndreqë vaskën për bagëtinë e vet, por s’do të ketë kohë ta mbushë me ujë. Një burrë do ta ngrejë kafshatën e bukës te goja e vet, por s’do të mund ta hajë atë”. [el-Buhari]

Hudhejfe ibn el-Jeman tha:

“Nga krejt njerëzit unë di më së shumti për secilin çrregullim që do të ndodhë nga tani deri te Çasti. Kjo s’është ngaqë peygamberi më ka thënë në fshehtësi diçka që s’i ka thënë tjetërkujt, por ngaqë isha i pranishëm mes një grupi njerëzish të cilëve ai u foli rreth çrregullimeve [fitneve]. Peygamberi i përmendi këto çrregullime, të cilat vështirë që do ta kursejnë ndonjërin; disa do të jenë si shtrëngata, disa më të mëdha e disa më të vogla. Secili nga ata që ishin të pranishëm aty, ka vdekur, përveç meje”. [Muslim]

Ebu Hurejre tha se kishte dëgjuar peygamberin [salallahu alejhi ue selam] të thotë:



“Nëse jetoni për një kohë, do të shihni njerëz që dalin nën hidhërimin e Allahut e kthehen nën mallkimin e Tij, dhe ata do të kenë në duart e tyre kamxhikë sikurse bishti i një kau”. [Ahmed, Muslim]

Ebu Hurejre tha se pejgamberi kishte thënë:

“Ka dy lloj njerëzish të xhehenemit të cilët hala s’i kam parë. Të parët janë njerëzit që kanë kamxhikë sikurse bishtat e demave, me të cilët i rrahin njerëzit, dhe të dytët janë gratë që janë të zhveshura, ndonëse janë të veshura, të cilat do të jenë të humbura dhe do t’i humbasin të tjerët, dhe kokat e tyre do të jenë si gunga devesh. Këto gra s’do të hyjnë në xhenet. Bile, ato s’do ta ndjejnë as aromën më të vogël të tij, ndonëse aroma e xhenetit mund të ndjehet nga kaq e kaq largësi”.

Enes ibn Malik tha që pejgamberi qe pyetur: “O i Dërguar i Allahut, çka do të ndodhë kur të mos urdhërojmë për të mirë dhe të mos ndalojmë nga e keqja?”. Ai tha:

“Do të ndodhë mes jush ajo që u ka ndodhur izraelitëve: do të përhapet kurvëria mes udhëheqësve tuaj, dija do të mbetet në duart e më të ulëtëve prej jush dhe pushteti do të kalojë në duart e më të padenjëve mes jush”. [Ibn Maxheh]

Ebu Hurejre tha se pejgamberi kishte thënë:

“Mjerë arabët për të keqen e madhe që po u afrohet. Ajo do të jetë sikurse copat e natës së errët. Një njeri do të zgjohet si besimtar dhe do të jetë mosbesimtar [kafir] në mbrëmje. Njerëzit do ta shesin fenë e tyre për një mirësi të vogël të dunjasë. Ai që zbaton fenë në atë ditë, do të jetë si ai që kap një gacë/apo thera”. [Ahmed]

Ebu Hurejre tha se kishte dëgjuar pejgamberin [salallahu alejhi ue selam] t’i thotë Theubanit:

- O Theuban, çka do të bëni kur popujt të thërrasin njëri-tjetrin për t’ju invaduar ashtu siç thërrasin njerëzit njëri-tjetrin për të ngrënë nga një sahan?
- U sakrifikofshin baba e nëna ime për ty! O i dërguar i Allahut, a do të jetë kështu ngaqë do të jemi të pakët? – pyeti Theuban.
- Jo. Në atë kohë do të jeni shumë, por Allahu do të fusë *wehn* [dobësi] ne zemrat tuaja.
- Çka është kjo dobësi [*wehn*], o i Dërguar i Allahut?
- Kjo është dashja e kësaj bote dhe urrejtja e luftimit. [Ahmed]

Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] ka thënë:

- Do të ketë çrregullime në të cilat ai që fle, do të jetë më i mirë se ai që rri i shtrirë; ai që rri i shtrirë, do të jetë më i mirë se ai që rri i ulur; ai që rri i ulur, do të jetë

më i mirë se ai që qëndron në këmbë; ai që qëndron në këmbë, do të jetë më i mirë se ai që ecën; ai që ecën, do të jetë më i mirë se ai që kalëron; ai që kalëron, do të jetë më i mirë se ai që vrapon. Krejt të vdekurit e tyre do të jenë në xhehenem.

- Kur do të jetë kjo, o i Dërguar i Allahut – pyeti sahabi.
- Kjo do të jetë në ditët e *herxh*.
- Kur do të jenë ditët e *harxh*?
- Kur njeriu s’do t’i besojë atij me të cilin flet.
- Çfarë më këshillon, nëse e përjetoj këtë, o i Dërguar i Allahut?
- Përmbahuni dhe kthehuni në shtëpitë tuaja.
- O i Dërguar i Allahut, çka të bëjë, nëse dikush më hynë në lagje për të më sulmuar?
- Ik në shtëpinë tënde.
- Çka nëse më hyn në shtëpi?
- Shko në vendin ku falesh dhe bëj kështu – dhe ai palosi duart, si në namaz – dhe thuaj: ‘Zoti im është Allahu’, derisa të vdesësh.

Ebu Bekreh tha që peygamberi [salallahu alejhi ue salam] kishte thënë:

- Do të ketë një çrregullim gjatë të cilit ai që rri i shtrirë, është më i mirë se ai që rri i ulur; ai që rri i ulur, do të jetë më i mirë se ai që qëndron në këmbë; ai që qëndron në këmbë, do të jetë më i mirë se ai që ecën; ai që ecën, do të jetë më i mirë se ai që vrapon.
- Çfarë më këshillon të bëjë, o i Dërguar i Allahut – pyeti dikush.
- Kushdo që ka deve, le të rrijë me to; kushdo që ka pronë të tijën, le të rrijë në pronën e vet.
- Çfarë të bëjë ai që s’e ka asnjërën nga këto? – pyeti dikush.
- Atëherë, lë ta marrë shpatën e tij dhe t’i mëshojë [thyejë] tehut të saj për guri e pastaj le të ikën sa më larg që ka mundësi. [Ebu Daud. Ka hadith të ngjashëm në Muslim]

Gjatë fitnes së kalifatit të Uthman ibn Affan, Sad ibn Ebi Uekkas tha: “Dëshmoj që peygamberi tha:

- Do të ketë një çrregullim gjatë të cilit ai që rri i ulur, do të jetë më i mirë se ai që qëndron në këmbë; ai që qëndron në këmbë, do të jetë më i mirë se ai që ecën; ai që ecën, do të jetë më i mirë se ai që vrapon.
- Çka më këshillon, nëse dikush hyn më hyn në shtëpi për të më vrarë? – pyeti dikush.
- Bëhu si biri i Ademit [dmth hiq dorë nga vetvetja]. [Muslim, et-Tirmidhi]

Ebu Musa el-Eshari tha që peygamberi [salallahu alejhi ue salam] kishte thënë:

“Para se të vijë Çasti, do të ketë një çrregullim si copat e natës së errët. Njeriu do të zgjohet si besimtar dhe do të bjerë në gjumë si një mosbesimtar, apo do të flejë

gjumë si një besimtar dhe do të zgjohet si një mosbesimtar. Ai që rri i ulur, do të jetë më i mirë se ai që qëndron në këmbë; ai që ecën, do të jetë më i mirë se ai që vrapon. Thyeni harqet tuaja, preni lidhëset e tyre dhe goditni shpatat për guri [për t'ua thyer tehun]. Nëse dikush vjen për të vrarë ndonjërin prej jush, atëherë bëhuni si më i miri prej bijve të Ademit". [Ebu Daud]

Ebu Dherr tha: "Pejgamberi po e ngiste një gomar dhe më uli mua mbas tij e më tha:

- O Ebu Dherr, nëse njerëzit do të vuajnë nga uria aq shumë, saqë s'do të mund të çohen nga shtrati për të shkuar në xhami, çfarë do të bësh?
- Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri – i thash.
- Ji i ndershëm dhe përmbahu.

Pastaj ai [salallahu alejhi ue selam] tha:

- O Ebu Dherr, nëse njerëzit do të vuajnë nga vdekje të ashpra [dmth nëse njeriu s'vlen më shumë sesa një varr], çfarë do të bësh? Dhe, nëse njerëzit do të vrasin njëri-tjetrin, derisa Haxheret el-Zejt [një regjion i Medinës] të mbytet në gjak, çfarë do të bësh?
- Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri – i thash
- Rri në shtëpinë tënde dhe mbylle derën.
- Çka nëse nuk më lënë?
- Atëherë, bëhu një prej tyre.
- Të kapi shpatën?
- Nëse do ta bëjë këtë, do t'u bashkëngjiteshe në punët e tyre. Jo. Nëse të shqetëson shkëlqimi i shpatës, mbuloje fytyrën me teshën tënde dhe lëre atë të mbartë gjynahun tënd e të tijin. [Ahmed]

Abdullah ibn Amr tha: "Ishim në një udhëtim me pejgamberin ... Kur myezini i pejgamberit thirri ezanin, shkova aty. Pejgamberi po u drejtohej njerëzve duke thënë:

'O njerëz, ka qenë detyrë e çdo pejgamberi para meje të udhëzonte popullin e tij në çfarëdo që e dinte se është mirë për ta dhe t'i paralajmëronte ata kundër çfarëdo që e dinte se është keq për ta. Por, kohën e paqes dhe të sigurisë ky umet e ka në fillim të tijin, kurse nga fundi i tij do të pësojë sprova dhe çrregullime të njëpasnjëshme. Çrregullimi do të vjen dhe besimtari do të thotë: 'Mbarova!', po ai do të kalojë. Një tjetër çrregullim do të vjen dhe ai do të thotë: 'Më erdhi fundi!', por do të kalojë. Dhe çrregullimi i radhës do të vjen dhe do të kalojë njëjtë. Kushdo që dëshiron të shpëtojë nga xhehenemi dhe të hyjë në xhenet, le të vdesë duke besuar në Allahun dhe në Ditën e Fundit dhe të sillet me njerëzit ashtu siç do që vetë të trajtohet. Nëse dikush i zotohet për besnikëri një imami, atëherë le t'i bindet, nëse mundet [në një rast tha: "Aq sa të mundet"]'."

Abd el-Rrahman [një nga transmetuesit e hadithit] tha: "Kur e dëgjova këtë, e lëshova kokën mes gjunjëve të mi dhe thashë: 'Por, kushëri yt, Muauije, po na urdhëron ta

shkapërderdhim pasurinë tonë së koti dhe ta vrasim njëri-tjetrin, kurse Allahu ka thënë  
« **O ju që besoni, mos e harxhoni pasurin tuaj në kotësi ...** » [el-Nisa, 29]

Abdullah ibn Amr tha: "Dëgjova peygamberin të thotë:

'Nga umeti im disa do t'i përpijë toka, disave do t'ju bie rrebesh gurësh dhe disa do të transformohen në shtazë'". [Ahmed]

## Shenjat dhe paralajmërimet

Abdullah ibn Amr tha:

“Shkova te peygamberi [salallahu alejhi ue salam] një ditë teksa ai po merrte abdes ngadalë dhe me kujdes. Ai ngriti kokën, më shikoi dhe tha:

Këtij umeti do t'i ndodhin gjashtë gjëra:

- Vdekja e peygamberit tuaj, dhe kjo është e para.

Kur e dëgjova këtë, u shtanga.

- E dyta është shtimi i pasurisë suaj deri në atë masë, saqë, sikur t'i jepen njeriut dhjetë mijë, ai s' do jetë i kënaqur.
- E treta është çrregullimi që do të hyjë në shtëpinë e secilit prej jush.
- E katërta është përhapja e vdekjes së befasishme.
- E pesta është marrëveshja e paqes mes juve dhe romakëve: ata do të grumbullojnë trupa kundër jush për nëntë muaj me radhë, si koha e pritjes së shtatzënës, pastaj ata të parët do ta thyejnë marrëveshjen.
- E gjashta është pushtimi i një qyteti'.  
Pyeta: 'Cili qytet, o i Dërguar i Allahut?'.  
• Kostandinopoja -, tha ai. [Ahmed]

Ebu Hurejra tha që Peygamberi [salallahu alejhi ue salam] kishte thënë:

“Ngutuni për të bërë punë të hajrit para se të ndodhin gjashtë gjëra: ngritja e diellit në Perëndim, Tymi, Dexhalli, Bisha, vdekja e ndonjërit prej jush apo çrregullimi gjithëpërfshirës”. [Ahmed, Muslim]

Hudhejfe ibn Ubejd tha: “Peygamberi erdhi tek ne ndërsa po diskutonim dhe na pyeti:

- Për çfarë po flisni?
- Po diskutojmë rreth Çastit.
- Ai s' do të ndodhë, derisa t'i shihni dhjetë shenja: Tymi, Dexhalli, Bisha, lindja e diellit në Perëndim, zbritja e Isës, birit të Merjemes; Jexhuxhët e Maxhuxhët, dhe tri rrëshqitje të tokës, njëra në Lindje, njëra në Perëndim dhe njëra në Arabi, në fund të së cilës do të shpërthejë një zjarr nga drejtimi i Adenit [Jemen] dhe do t'i shtyjë njerëzit për tek vendi i tubimit përfundimtar”. [Ahmed]

## Beteja me romakët

Pas betejës me romakët, e cila përfundon me pushtimin e Kostandinopojës, do të shfaqet Dexhalli, kurse Isa, biri i Merjemes, do të zbresë nga qielli në tokë, te minarja e bardhë në Damask, gjatë kohës së namazit të sabahut, siç do të shohim në hadithet e vërteta.

Dhu Mukhemmer tha se Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Ju do të bëni një marrëveshje me romakët dhe së bashku do ta invadoni një armik përtej Romës. Ju do të fitoni dhe do të merrni një plaçkë të madhe. Pastaj, ju do të ngrini kampin në një kodrinë. Njëri nga romakët do të vjen e do ta ngrejë kryqin dhe do të thotë: ‘Fitore kryqit!’ Kështu, një nga muslimanët do ta vrasë atë e pastaj romakët do ta thyejnë marrëveshjen dhe do të zhvillohet një betejë. Ata do të grumbullojnë një ushtri kundër jush dhe do të dalin kundër jush me tetëdhjetë flamuj, ku nën secilin flamur do të ketë dhjetëmijë burra”. [Ahmed, Ebu Daud, Ibn Maxheh]

Jusejr ibn Xhabir tha:

“Një herë e një kohë, Kufen e goditi një stuhi e kuqe. Një burrë erdhi dhe pyeti: ‘O Abdullah ibn Mes’ud, a erdhi Çasti?’ Abdullahu po rrinte i mbështetur dhe tha: ‘Çasti s’do të vjen, derisa njerëzit të mos ndajnë trashëgiminë e as të mos i gëzohen plaçkës’. Duke treguar nga Siria, ai tha: ‘Një armik do të tubojë forca kundër muslimanëve dhe muslimanët do të tubojnë forca kundër tyre’. Pyeta: ‘A po mendon në romakët?’ Ai tha: ‘Po. Atëkohë, do të ketë luftime të ashpra. Muslimanët do të përgatisin një njësit për të luftuar deri në vdekje. Ata s’do të kthehen, përveç si fitimtarë, dhe do të luftojnë, derisa të bie nata. Të dy palët do të kthehen pa fituar ndonjëra prej tyre dhe do të ketë shumë viktime në të dy anët. Në ditën e katërt, muslimanët e mbetur do t’i kthehen luftimeve dhe Allahu do të bëjë që armiku të shpartallohet. Do të zhvillohet një betejë e paparë, saqë, sikur të fluturonte një zog mbi radhët e tyre, do të binte i vdekur para se të mbërrinte fundin e tyre. Nga një familje njëqind anëtarësh veç një burrë do të mbijetojë. Pra, si mund ai t’i gëzohet plaçkës apo të ndajë trashëgiminë? Derisa ata janë në këtë gjendje, do të dëgjojnë për një fatkeqësi edhe më të madhe. Ata do t’i mbërrijë klithja: ‘Dexhalli ka zënë vend midis fëmijëve tuaj!’ Kështu, ata do të hedhin krejt çfarë kanë në duart e tyre dhe do të vazhdojnë përpara, duke çuar 10 kalorës si njësit vëzhgues. Pejgamberi tha: ‘Unë i di emrat e tyre, emrat e baballarëve të tyre si dhe ngjyrat e kuajve të tyre. Në atë ditë, s’do të ketë kalorës më të mirë se ata mbi faqen e dheut’”. [Ahmed, Muslim]

Ebu Hurejre tha se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Çasti s’do të vjen, derisa romakët të ngritin kampin në el-A’mesh apo në Dabik. Një ushtri e përbërë nga njerëzit më të mirë në tokë në atë kohë, do të dalë nga Medina për t’u përballur me ta. Kur ata të jenë vendosur në radhë, romakët do të

thonë: 'Mos na pengoni nga ata që kanë zënë robër disa nga tanët. Ejani të luftojmë me ta'. Një e treta e tyre do të ikin dhe Allahu kurrë s' do t'ua falë. Një e treta do të vriten dhe ata do të jenë dëshmorët më të mirë në shikimin e Allahut. Një e treta, të cilët kurrë s' do t'u nënshtrohen sprovave e çrregullimeve, do të fitojnë dhe do ta pushtojnë Kostandinopojën. Ndërsa ata do të jenë duke ndarë plaçkën dhe pasi t'i kenë varur armët në një dru ulliri, shejtani do të thërrasë se Dexhalli ka zënë vendin e tyre në familjet e tyre. Kur ata të vijnë në Siri, Dexhalli do të shfaqet ndërsa ata do të përgatitën për betejë duke pozicionuar radhët e tyre. Kur të vjen koha e namazit, do të zbresë Isa, biri i Merjemes, dhe do t'i udhëheqë në namaz. Kur armiku i Allahut [Dexhalli] ta shohë atë, do të nisë të tretet si kripa në ujë, por Allahu do ta vrasë atë". [Muslim]

Pejgamberi tha:

"Çasti s' do të vjen, derisa kufiri më i skajshëm i muslimanëve të jetë në Bula". Pastaj tha: "O Ali". "U sakrifikofshin nënë e baba im për ty!" – ia ktheu ai. "Ju do t'i luftoni romakët dhe, ata që do të vijnë pas jush, do t'i luftojnë ata, derisa burrat më të mirë nga muslimanët, burrat e Hixhazit, do të dalin për t'i luftuar ata duke mos iu tutur kurrkujt pos Allahut. Ata do ta pushtojnë Kostandinopojën me *tesbih* e me *tekbir* [duke thënë *subhanAllah* dhe *Allahu ekber*], dhe ata do të marrin një plaçkë të paparë ndonjëherë, të cilën do ta shpërndajnë duke e gërryer me mburojat e tyre. Dikush do të vjen e do të thotë: 'Dexhalli është shfaqur në vendin tuaj', por ai do të rrejë. Kushdo që do t'ia vërë veshin, do të pendohet; kushdo që do ta injorjë, do të pendohet". [Ibn Maxheh]

Nafi ibn Utbeh se pejgamberi kishte thënë:

"Ju do ta sulmoni Arabinë dhe Allahu do t'jua mundësojë pushtimin e saj. Pastaj do ta sulmoni Persinë dhe Allahu do t'jua mundësojë pushtimin e saj. Pastaj do ta sulmoni Romën dhe Allahu do t'jua mundësojë pushtimin e saj. Pastaj do ta sulmoni Dexhallin dhe Allahu do t'jua mundësojë mposhtjen e tij". [Muslim]

Ndërsa Musteurid el-Kureshi po rrinte i ulur me Amr ibn el-As, ai tha:

"Dëgjova pejgamberin të thotë: 'Çasti do të vjen, kur romakët të jenë shumicë'. Amr e pyeti: 'Çfarë thua?!' Ai tha: 'Po e përsëris atë që dëgjova nga pejgamberi'. Amr tha: 'Nëse e thua këtë, është e vërtetë, sepse ata kanë katër karakteristika të mira. Ata janë më të zotët në përballimin me çrregullime. Ata më së shpejti e marrin veten pas fatkeqësisë. Ata më së miri i trajtojnë varfanjakët, të dobëtit dhe jetimët. Dhe ata kanë edhe një karakteristikë që është shumë e mirë: ata nuk lejojnë që t'u bëjnë zullum mbretërit e tyre'. Pejgamberi tha: 'Ju do t'i luftoni romakët, dhe besimtarët nga Hixhazi do t'i luftojnë ata pas jush, derisa Allahu t'ua mundësojë pushtimin e Kostandinopojës dhe Romës me *tesbih* e me *tekbir*.

Fortifikatat e tyre do të shemben dhe ata do të marrin një plaçkë të paparë, në mënyrë që do ta shpërndajnë duke e gërryer me mburojat e tyre. Pastaj dikush do të klithë: 'O muslimanë! Dexhalli është në tokën tuaj me familjet tua!', dhe njerëzit do ta lënë pasurinë. Kushdo që ia vë veshin kësaj, do të pendohet; kushdo që do ta injorojë, do të pendohet. Ata do të pyesin: 'Kush bërtiti?', por s' do ta dinë kush që ai. Do të thonë: 'Do të dëgjoni për punët e tij'. Kështu, ata do të shkojnë e të shohin dhe, nëse shohin që gjithçka është normale, do të thonë: 'Kurrkush s' do të klithte në atë mënyrë pa ndonjë arsye. Ejani të shkojmë në Ilje!. Nëse e gjejmë Dexhallin aty, do të luftojmë së bashku, derisa Allahu të vendosë mes nesh dhe atij. Nëse s' e gjejmë Dexhallin, do të kthehemi në vendin tonë dhe te familjet tona''.

Muadh ibn Xhebek ka thënë se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Ndërtimi i Bejt el-Makdis [në Palestinë] do të pasohet me shkatërrimin e Jethrib [Medines], çka do të pasohet me pushtimin e Kostandinopojës, çka do të pasohet me shfaqjen e Dexhallit. Pastaj ai vendosi dorën në kofshën apo në krahun e njërit me të cilin po fliste [Muadh] dhe tha: 'Kjo është e vërtetë ashtu siç është e vërtetë që ju jeni këtu të pranishëm''.

Kjo s' do të thotë që Medina do të shkatërrohet plotësisht para ardhjes së Ditës, por do të ndodhë nga fundi i kohës, siç do të shohim në disa hadithe të vërteta. Mirëpo, ndërtimi i Bejt el-Makdis do të jetë shkak për shkatërrimin e Medines, siç është dëshmuar në hadithin ku Dexhalli s' do të mund të hyjë në Medine, sepse do të jetë e rrethuar nga engjëjt që mbajnë shpata të hequra nga këllëfi. Ebu Hurejre tha se, lidhur me Medinen, pejgamberi kishte thënë:

“Në Medine s' mund të hyjë as ndonjë sëmundje epidemike, as Dexhalli”. [el-Buhari]



## Shfaqja e Dexhallit

Së pari, do të citojmë disa transmetime të cilat përmendin gënjeshtarët dhe “dexhallët”, të cilët do t’i paraprijnë ardhjes së Dexhallit, i cili do të jetë i fundit prej tyre – Allahu i mallkoftë dhe i dënoftë me zjarrin e xhehenemit.

Xhabir ibn Semureh tha se kishte dëgjuar pejgamberin [salallahu alejhi ue selam] të thotë:

“Pak para Çastit, do të ketë shumë gënjeshtarë”. Dhe Xhabiri tha: “Të jini të gatshëm kur të vijë”. [Muslim]

Xhabir tha se kishte dëgjuar pejgamberin [salallahu alejhi ue selam] të thotë:

“Pak para Çastit, do të ketë shumë gënjeshtarë. Midis tyre është një në el-Jemameh, Ensi në San’a, njëri në Himjer, dhe Dexhalli. Ky do të jetë çrregullimi më i madh”. [Ahmed]

Ebu Hurejre tha se pejgamberi kishte thënë:

- Çasti s’do të vjen, derisa të shfaqen 30 ‘dexhallë’ dhe secili prej tyre të pretendojë se është i Dërguar i Allahut, të shtohet pasuria, të paraqiten çrregullimet dhe të shtohen *el-Herxh*.
- Çka është *el-Herxh*? – pyeti dikush.
- Vrasje! Vrasje! – tha ai. [Ahmed]

Ebu Hurejre tha se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Çasti s’do të vjen, derisa të shfaqen 30 ‘dexhallë’ dhe të gjithë prej tyre të rrejnë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij”. [Ebu Daud]

Ebu Hurejre tha se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Pak para Çastit, do të ketë 30 ‘dexhallë’ dhe secili prej tyre do të thotë: ‘Unë jam pejgamber’”. [Ahmed]

Ebu Hurejre tha se pejgamberi kishte thënë:

“Do të ketë ‘dexhallë’ dhe gënjeshtarë në umetin tim. Ata do t’ju thonë gjëra të reja, të cilat s’i keni dëgjuar as ju e as gjyshërit tuaj. Ruhuni prej tyre dhe mos lini t’ju humbasin”. [Ahmed]

Theuban tha se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Do të ketë 30 gënjeshtarë në umetin tim. Secili prej tyre do të pretendojë se është peygamber, por unë jam i fundit nga peygamberët dhe s’do të ketë me peygamberi pas meje”. [Ahmed]

Ibn Umer tha se kishte dëgjuar peygamberin [salallahu alejhi ue selam] të thotë:

“Në umetin tim do të ketë më shumë se 70 thirrës dhe secili prej tyre do të thërrasë për në Zjarrin e xhehenemit. Po të doja, do t’jua kallëzoja emrat dhe fiset e tyre”.

Ebu Bekreh tha: “Njerëzit folën shumë kundër Musejlemes para se peygamberi të thoshte diçka rreth tij. Pastaj peygamberi u çua për të mbajtur fjalim dhe tha:

‘... sa i përket këtij njeriu për të cilin keni folur aq shumë, ai është një nga 30 gënjeshtarët të cilët do të shfaqen para Çastit, dhe s’ka qytet që s’do të ndjejë frikën nga Dexhalli’”. [Ahmed]

Në një tjetër version të këtij transmetimi, peygamberi [salallahu alejhi ue selam] tha:

“Ai është një nga 30 gënjeshtarët të cilët do të shfaqen para Dexhallit. S’ka asnjë qytet që s’do ta përjetojë frikën nga Dexhalli, përveç Medines. Atëkohë, në hyrje të Medines do të qëndrojnë dy engjëj duke mënjanuar frikën nga Dexhalli”.

Enes ibn Malik tha se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

- Koha e Dexhallit do të jenë vite pëstjellimi. Njerëzit do t’i besojnë një gënjeshtari e do ta mohojnë atë që flet të vërtetën. Njerëzit s’do t’i besojnë besnikut dhe do t’i besojnë mashtruesit, dhe *Ruwejbide-s* do t’ju vjen rendi për të folur.
- Kush janë *Ruwejbide*? – pyeti dikush.
- Ata që rebelohen kundër Allahut dhe u shkon fjala në çështjet e përgjithshme – u përgjigj ai. [Ahmed]

## Hadithet rreth Dexhallit

Abdullah ibn Umer tha: “Umer ibn el-Khatib, bashkë me peygamberin dhe me një grup njerëzish, shkuan te Ibn Sejjed dhe e gjetën atë teksa po luante me disa fëmijë afër

frëngjive të Benu Megheleh. Atëkohë, Ibn Sejjed ishte në prag të pubertetit. Ai nuk po e vërente që dikush po i afrohej, derisa pejgamberi e goditi në shpinë dhe i tha:

- A dëshmon ti që unë jam i Dërguar i Allahut?

Ibn Sejjed e shikoi atë dhe tha:

- Dëshmoj që ti je i Dërguar i analfabetëve. – Dhe tha: A dëshmon ti që unë jam i Dërguar i Allahut?

Pejgamberi nuk e pranoi këtë dhe tha:

- Besoj në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij -, dhe e pyeti: Çfarë po sheh?
- Nganjëherë shoh një besnik, nganjëherë një gënjeshtar – ia ktheu Ibn Sejjed.
- Je ngatërruar – i tha pejgamberi, dhe vazhdoi: Unë po fsheh diçka nga ti?
- Ajo është *Dukh* – tha Ibn Sejjed.
- Hesht! Ti s’do të mund të shkosh përtej nivelit tënd – i tha pejgamberi.
- Më lër t’ia presë kokën, o i Dërguar i Allahut – ndërhyri Umer ibn el-Khatab.
- Nëse ky është Dexhalli, s’do të jeni në gjendje ta mposhtni; nëse s’është, vrasja e tij s’do të sjellë ndonjë të mirë – tha pejgamberi.

Selim tha se Abdullah ibn Umer kishte thënë: “Pejgamberi u çua dhe iu foli njerëzve. Ai e lavdëroi Allahun siç Ai e meriton dhe më pas foli rreth Dexhallit:

‘Po ju paralajmëroj kundër tij. S’ka asnjë pejgamber që s’ka paralajmëruar kundër tij, bile edhe Nuhu i paralajmëroi popullin e tij për të. Por, unë do të ju kallëzoj rreth tij diçka që asnjë pejgamberi s’i ka kallëzuar popullit të tij. Ju duhet ta dini se Dexhalli është me një sy, kurse Allahu s’është me një sy’.

Ibn Shihab tha: “Umer ibn Thabit el-Ensari më ka thënë se disa nga sahabët e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] i ka thënë atij se, në ditën kur ai paralajmëroi njerëzit rreth Dexhallit, kishte thënë:

‘Mes syve të tij, do të jetë e shkruar fjala *kafir* [mosbesimtar]. Gjithkush që i ka në zët punët e veta të këqija – apo çdo besimtar – do të jetë në gjendje ta lexojë’. Po ashtu tha: ‘Ju duhet ta dini se asnjë prej jush s’do të jetë në gjendje ta shohë Zotin, derisa të vdesë’’. [Muslim, el-Buhari]

Ibn Umer tha: “Pejgamberi ua përmendi Dexhallin njerëzve dhe tha:

‘Allahu s’është me një sy, por Dexhalli është qorr në syrin e tij të djathtë dhe syri i tij është si një kokërr rrushi që pluskon’’. [Muslim]

Enes bin Malik tha se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Kurrë s’ka pasur pejgamber e të mos ketë paralajmëruar popullin e tij kundër gënjeshtarit me një sy qorr. Vërtet, ai është me një sy, kurse Zoti juaj s’është me

një sy. Në ballin e tij do të jenë të shkruara shkronjat *Kef, Fa, Ra [Kafir]*". [Muslim, el-Buhari]

Hudhejfe tha se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Më mirë di unë për mundësitë që do t'i ketë Dexhalli, sesa ai vetë. Ai do t'i ketë dy lumenj; njëri do të duket si ujë i kthjellët, kurse tjetri do të duket si zjarr flakërues. Kushdo që e sheh këtë, le ta zgjedhë lumin që duket si zjarr e pastaj le t'i mbyllë sytë, ta ulë kokën e të pijë prej tij, sepse ai do të jetë uji i ftohët. Dexhalli do të jetë me një sy. Vendin e syrit do ta ketë të mbuluar me një copë lëkure. Në ballin e tij do të jetë e shkruar fjala *kafir*, dhe çdo besimtar, qoftë analfabet, qoftë i mësuar, do të mund ta lexojë atë". [Muslim]

Muhamed ibn Mundekir tha: "Pashë Xhabir ibn Abdullahun të betohej në Allahun se Ibn Sejjed ishte Dexhalli, kështu që e pyeta: 'Bëj be në Allahun?!' Ai tha: 'Dëgjova Umerin të betohej për këtë në prani të pejgamberit dhe pejgamberi nuk e mohoi këtë'".

Disa dijetarë thonë se disa sahabë besonin që Ibn Sejjed ishte Dexhalli i madh, por kështu nuk qëndron puna. Ibn Sejjed ishte nga Dexhallët më të vegjël. Ibn Sejjed udhëtoi mes Mekes dhe Medines me Ebu Se'id dhe iu ankua atij për atë se njerëzit thoshin se ai ishte Dexhalli. Dhe ai i kishte thënë Ebu Se'idit: "A nuk ka thënë pejgamberi se Dexhalli s'do të hyjë në Medine? Unë jam lindur aty. A nuk ka thënë se Dexhalli s'do të ketë fëmijë? Unë kam fëmijë. A nuk ka thënë se Dexhalli do të jetë kafir? Unë pranova Islamin. Nga krejt njerëzit, unë di më së shumti për të. Unë e di ku është tash ai. Sikur të më jepej mundësia të jem në vendin e tij, nuk do të refuzoja". [el-Buhari, Muslim]

Ka shumë hadithe rreth Ibn Sejjed, disa nga të cilat nuk janë të qarta rreth faktit se a i ishte ai Dexhalli, apo jo. Do të shohim hadithet që tregojnë se Dexhalli s'është Ibn Sejjed, si në hadithin e Fatimeh bin Kajs el-Fehrijeh, ndonëse kjo s'do të thotë që ai s'ishte nga dexhallët më të vegjël, por Allahu e di më së miri.

## Hadithi i Fatima bint Kajs

Amir bin Sherehil Sha'bi Sha'b Hamdan transmetoi se ai kishte pyetur Fatima bint Kajs, motrën e Dahhak ibn Kajs, e cila ishte një nga migrueset e para:

- Ma trego një hadith që ke dëgjuar drejtpërdrejt nga i Dërguari, pa ndonjë ndërmjetësues.
- Nëse do, mund ta them – i tha ajo.
- Po, të lutëm, ma thuaj.
- Unë u martova me Ibn el-Mughireh, i cili ishte një nga të rinjtë më të mirë të Kurejshëve asokohe, por ai ra në xhihadin e parë në anën e të Dërguarit. Kur mbeta vejushë, njëri nga sahabët e pejgamberit, AbduRrahman ibn Auf, ma

propozoi martesën. Po ashtu, peygamberi ma propozoi për martesë robin e tij të lirë Usama bin Zejd. Më është thënë se peygamberi kishte thënë: 'Ai që më do mua, duhet ta dojë dhe Usamen'. Kur peygamberi me foli, i thashë:

- Bëj çfarë të duash. Më marto për kë do ti.
- Shko dhe rri me Umm Sherik – më tha.

Umm Sherik ishte një grua ensare e pasur, e cila harxhonte shumë në rrugë të Allahut dhe i respektonte musafirët. Unë i thashë:

- Do të bëjë si do ti.

Pastaj ai [salallahu alejhi ue selam] tha:

- Jo, mos shko. Umm Sherik ka shumë musafirë dhe unë nuk dua që rastësisht të zbulohet koka apo këmba dhe njerëzit të shohin diçka që ti s' do të doje ta shihnin. Është më mirë për ty të shkosh të kushëriri yt Abdullah ibn Amr ibn Umm Mektum.

Kështu, unë shkova te ai dhe, kur kreu periudhën e pritjes [*iddeh*], dëgjova zërin e myezinit të peygamberit tek thërriste ezanin. Shkova në xhami dhe u fala mbas peygamberit, në safin e grave, që ishte mbrapa xhematit. Kur peygamberi kreu namazin, u ul në mimber dhe, duke buzëqeshur, tha:

- Secili le të rrijë aty ku është – dhe më pas tha: A e dini përse ju kërkova të mblidheni?
- Allahu e di Dërguari i tij e dinë më së miri – thanë njerëzit.
- Pasha Allahun, nuk ju kam mbledhur që të këshilloj apo t'ju paralajmëroj. Ju mbajta këtu, sepse Temim ed-Darij, një i krishterë që pranoi Islamin, më tha diçka që përputhet me atë që unë ju kam thënë rreth Dexhallit. Ai më tha se kishte lundruar në një anije së bashku me 30 burra nga Ebnu Lekhm dhe Benu Xhudham. Valët e detit i kishin hedhur andej-këtej për rreth një muaj. Pas kësaj, ata u sollën afër një ishulli pak para perëndimit të diellit. Ata zbarkuan në atë ishull, ku u takuan me një bishë e cila aq shumë ishte e mbuluar me lesh, sa që nuk mund ta dallonin se cila ishte ana e përparme apo pasme e saj. Ata thanë:
- Mjerë ti! Kush je ti?
- Unë jam el-Xhessaseh – u përgjigj krijesa.
- Çka është el-Xhessaseh – e pyetën ata.
- O njerëz, shkoni të ai njeriu në manastir, se mezi po pret t'ju takojë.

Temim tha që, kur krijesa e përmendi emrin, u tutëm se mos po qëllon ndonjë dreq. Dhe ne shpejt shkuam në manastir, ku gjetëm një njeri vigan, me duart e lidhura deri në qafën e tij dhe me pranga të hekurta mes këmbëve deri në nyej. Thamë:

- Mjerë ti! Kush je ti?
- Së shpejti do të dini se kush jam unë, por më thoni kush jeni ju?
- Ne jemi nga Arabia. Ne lundruam në një anije dhe valët na endën për një muaj dhe na sollën në ishullin tënd, ku takuam një bishë që ishte aq shumë e mbuluar me lesh, sa që s'mund ta dallonim anën e përparme nga ana e pasme e saj. Ne e pyetëm se kush ishte dhe na tha se quhej el-Xhessaseh. E pyetëm se çka ishte el-Xhessaseh dhe ajo na udhëzoi për tek një njeri në manastir, që mezi po priste të na takonte.

- Më tregoni për palmat e Bejsanit – tha burri.
- Çfarë do të dish për to?
- Dua të di nëse këto palma frutojnë.
- Po – i thamë.
- Së shpejti s’do të frutojnë më – dhe më pas tha: Më tregoni për liqenin e Taberijes [në Palestinë].
- Çfarë do të dish për të?
- A ka ujë në të dhe a e vadisin tokën me të?
- Po, ka shumë ujë dhe njerëzit e vadisin tokën me të.
- Më tregoni për pejgamberin analfabet. Çfarë ka bërë ai?
- Ai e la Meken dhe shkoi në Medine.
- A po luftojnë arabët kundër tij?
- Po.
- Si silllet ai me ta?

I treguam që pejgamberi i ka mposhtur arabët rreth tij dhe ata e po e pasojnë atë.

- Vërtet kjo paska ndodhur? – pyeti ai.
- Po.
- Është më mirë për ta që ta pasojnë atë. Tash do t’ju tregoj se kush jam unë. Unë jam Dexhalli. Së shpejti do të më lejohet ta lë këtë vend dhe unë do të shfaqem e do të udhëtoj nëpër tokë. Për 40 net do të kalojë nëpër secilin qytet, përveç Mekes dhe Medines, sepse këto më janë ndaluar. Sa herë të përpiqem të hyjë në to, do ta takojë një engjëll me shpatë te hequr nga këllëfi, i cili do të më pengojë të hyj. Do të ketë engjëj që i ruajnë ato në çdo shteg që çon për te to.

Fatima tha: “Pejgamberi tha: ‘Kjo është *Tajjibeh!* Kjo është *Tajjibeh!* Kjo është *Tajjibeh!* [dmth Medina]. A nuk ju kam treguar për këto gjëra?’ Njerëzit thanë: ‘Po’. Ai tha: ‘Më pëlqeu takimi që ma tregoi Temimi, sepse pajtohet me atë që jua kam treguar rreth Dexhallit dhe rreth Mekes e Medines. Vërtet, ai gjendet ne detin e Sirisë apo në atë të Jemenit. Jo, përkundrazi, ai gjendet në Lindje, ai gjendet ne Lindje, ai gjendet në Lindje’, dhe ai tregoi nga Lindja. Fatima tha: ‘Këtë e kam mbajtur në mend’. [Muslim]

Abdullah ibn Umer tha se pejgamberi kishte thënë:

“Ndërsa po flija, pashë veten në një ëndërr duke bërë *tawaf* Qaben. Pashë një burrë me fytyrë të kuqërremtë e me flokë të drejta dhe koka i pikonte ujë. Thashë: ‘Kush është ky?’ Më thanë: ‘I biri i Merjemes [Isa]’. Pastaj u ktheva mbrapa dhe pashë një tjetër burrë trupmadh, me fytyrë të kuqe, me flokë dredha-dredha dhe me një sy qorr. Syri tjetër i tij dukej si një kokërr rrushi që pluskon. Ata thanë: ‘Ky është Dexhalli’. Ai që më së shumti i përngjan atij, është Ibn Ketan, një burrë nga fisi el-Khuza’eh’”. [el-Buhari, Muslim]

Xhabir ibn Abdullah tha se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Dexhalli do të shfaqet nga fundi i kohës, kur njerëzit do të jenë të shkujdesur ndaj fesë. Ai do t’i ketë 40 ditë, gjatë të cilave do të udhëtojë nëpër tokë. Një nga këto ditë do të jetë si një vit, tjetra si një muaj, e treta si një javë dhe pjesa tjetër e ditëve si ditët normale. Ai do të ngasë një gomar. Gjerësia mes veshëve të tij do të jetë 40 kut. Ai do t’u thotë njerëzve: ‘Unë jam zoti juaj’. Ai është me një sy, kurse Zoti juaj s’është me një sy. Në ballin e tij do të ketë të shkruar fjalën *kafir* dhe çdo besimtar, qoftë i mësuar, qoftë analfabet, do të jetë në gjendje ta lexojë atë. Ai do të shkojë gjithkund, përveç në Meke dhe në Medine, të cilat Allahu ia ka ndaluar atij – engjëjt qëndrojnë tek portat e tyre. Ai do të ketë një mal me bukë dhe njerëzit do të përballen me vështirësi, përveç atyre që do ta pasojnë atë. Ai do t’i ketë dy lumenj dhe unë e di çfarë ka në to. Njërin do ta quajë xhenet, kurse tjetrin xhehenem. Kushdo që hyn në atë që e quajnë xhenet, do të gjejë në të zjarrin; kushdo që hyn në atë që quhet xhehenem, do ta gjejë xhenetin. Së bashku me të, Allahu do të dërgojë shejtanë të cilët do t’u flasin njerëzve. Ai do të sjellë çrregullime të mëdha. Ai do ta urdhërojë qiellin dhe njerëzve do t’u duket sikur po bie shi. Pastaj, ai do të duket se po e vret dikë dhe po e ringjallë. Pas kësaj, ai më s’do ta ketë këtë fuqi. Njerëzit do të thonë: ‘A mund të bëjë dikush tjetër këtë gjë, përveç Zotit?’ Muslimanët do të ikin në Xhebel el-Dukhan, në Siri, dhe Dexhalli do të vjen e do t’i rrethojë ata. Rrethimi do të ashpërsohet dhe ata do të vuajnë shumë. Pastaj, Isa, biri i Merjemes, do të zbresë dhe do t’i thërrasë njerëzit në agim: ‘O njerëz, çka ju pengoi të dilnit e ta luftonit këtë gënjeshtar?’ Ata do të përgjigjen: ‘Ai është një xhin’. Pastaj, ata do të dalin e do ta shohin Isën, birin e Merjemes. Do të vjen koha për namaz dhe muslimanët do ta thërrasin Isën për t’i udhëhequr në namaz, por ai do të thotë: ‘Le të udhëheq namazin imami juaj’. Imami i tyre do t’i udhëheqë në namazin e sabahut e pastaj ata do të dalin për ta luftuar Dexhallin. Kur gënjeshtari ta shohë Isën, ai do të tretet si kripa në ujë. Isa do ta mbërrijë dhe do ta vrasë, dhe s’do ta lëshojë të gjallë asnjë që e kishte pasuar atë’’. [Ahmed]

## Hadithi i el-Nuwes ibn Sem’en el-Kilabij

El-Nuwes bin Seman tha:

“Një mëngjes, pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] foli rreth Dexhallit. Nganjëherë ai e përshkruante si të parëndësishëm, nganjëherë e përshkruante atë të rrezikshëm, saqë na mbushej mendja se ai gjendej te grumbulli i palmave aty afër. Kur shkuam te ai më vonë, ai vërejti frikën në fytyrat tona dhe pyeti:

- Çfarë kini?
- O i dërguar i Allahut, këtë mëngjes ju folët rreth Dexhallit. Nganjëherë e përshkruaje si të parëndësishëm, nganjëherë e përshkruaje atë të rrezikshëm, saqë mendonim se ai është te grumbulli i palmave aty afër.

- Unë kam frikë për ju nga çështje tjera krahas Dexhallit. Nëse ai shfaqet ndërsa unë jam mes jush, unë do ta luftojë atë për ju. Por, nëse ai shfaqet e unë s'jam mes jush, atëherë secili njeri duhet të luftojë për veten e tij dhe Allahu do të kujdeset për çdo musliman në emër timin. Dexhalli do të jetë një i ri, më flokë të shkurta dredha-dredha dhe me një sy pluskues. Them që ai i përngjan Abdeluzza ibn Ketanit. Kushdo prej jush që jeton për ta parë atë, le të lexojë ajetet e fillimit të sures Kehf. Ai do të paraqitet në rrugën mes Sirisë dhe Irakut, dhe do të shkaktojë katastrofa majtas e djathtas. O robër të Allahut, kapuni për shtegun e së vërtetës.
- O i Dërguar Allahut, a do të mjaftojnë pesë namazet ditore për ditën që do të jetë si një vit?
- Jo, ju duhet ta llogarisni kohën dhe pastaj të faleni.
- O i dërguar i Allahut, sa shpejt do të udhëtojë ai nëpër tokë?
- Si një re që e shtyn era. Ai do t'ju vjen njerëzve dhe do t'i thërrasë [në fe të rrejshme] dhe ata do t'i besojnë dhe do t'i përgjigjen. Ai do t'i japë urdhër qiellit dhe do të bjerë shi; do të urdhërojë tokën dhe ajo të japë frytet. Pasi të mbledhin këto fryte, kafshët e tyre do të kthehen me gjinj të plot qumësht e me ijët e zgjeruara. Pastaj ai do t'i shkojë një populli tjetër dhe do t'i thërrasë [në fe të rrejshme], por ata do ta refuzojnë. Ai do të ndahet prej tyre dhe ata do të përjetojnë krizë dhe s'do t'u mbetet asnjë formë pasurie. Pastaj, ai do të kalojë nëpër shkretëtirë dhe do të thotë: 'Nxirri thesaret tua' dhe thesaret do të dalin sikurse tufa bletësh. Pastaj, ai do ta thërrasë një të ri në shkëlqimin e rinisë së tij, të cilin do ta godasë me shpatë dhe e ta ndajë në dysh. Pastaj, do t'i vendosë dy pjesët në largësinë si largësia mes një shigjetari dhe cakut të tij. Pastaj, do ta thërrasë atë dhe i riu do të vjen duke vrapuar dhe duke qeshur. Atëherë, Allahu do ta zbresë Mesinë, birin e Merjemes, dhe ai do të zbresë tek minarja e bardhë në lindje të Damaskut, duke mbartur dy tesha të bardha, të lyera me safron, dhe duke mbajtur duart në krahët e dy engjëjve. Kur ai të ulë kokën, nga ajo do të bien pika djerse dhe, kur të ngrejë kokën, nga ajo do t'i shpërndahen pika si margaritarë. Çdo kafir që ndjen erën e tij, do të vdesë, dhe fryma e tij do të mbërrijë aq sa sheh ai. Ai do ta kërkojë Dexhallin, derisa ta gjejë te portat e Luddit, ku edhe do ta vrasë. Pastaj, njerëzit të cilët i ka mbrojtur Allahu, do të vijnë te Isa dhe ai do t'jua fshijë fytyrat e tyre [dmth do t'ua fshijë gjurmët e vështirësive nga fytyrat] dhe do t'ua tregojë gradat në xhenet. Atëherë, Allahu do t'i shpallë Isës: 'Unë kam nxjerr disa nga robërit e Mi, të cilët kurrkush s'mund t'i luftojë. Strehoji robërit e Mi në Tur'. Pastaj Allahu do të dërgojë Jexhuxhët e Mexhuxhët, të cilët do të mësyjnë nga çdo shpat. I pari prej tyre do kalojë pranë liqenit të Tiberias dhe do të pijë nga uji i tij; i fundit prej tyre do të kalojë atypari dhe do të thotë: 'Këtu, dikur ka pasur ujë'. Isa, peygamberi i Allahut, dhe shoqëruesit e tij do të rrethohen, derisa një kokë dëmi do të jetë më e dashur për ta, sesa njëqind dinarë për ju sot. Pastaj, Isa dhe shoqëruesit e tij do t'i luten Allahut dhe Ai do të zbresë insekte të cilat do t'i kafshojnë Jexhuxhët e Mexhuxhët në qafët e tyre, kështu që, në



mëngjes, ata do të zhduken si një. Pastaj, Isa dhe shoqëruesit e tij do të zbresin dhe s’do të gjejnë asnjë cep apo të qarë në tokë pa kundërmimin e trupave të tyre të qelbur. Isa dhe shoqëruesit e tij prapë do ta lusin Allahun, i cili do të çojë shpezë me koka si të deveve, të cilat do të kapin trupat e Jexhuxhëve dhe Mexhuxhëve dhe do t’i hedhin aty ku do Allahu. Pastaj, Allahu do të zbresë shiun të cilin s’do të mund ta presë asnjë shtëpi e asnjë tendë, dhe toka do të pastrohet e të bëhet si një pasqyrë. Pastaj tokës do t’i thuhet të nxjerrë frytet dhe ta rikthejë bereqetin e vet. Në atë ditë, një grup njerëzish do të hanë nga një shegë dhe do të strehohen nën lëvoren e saj [aq e madhe do të jetë shega]. Deveja do të japë aq shumë qumësht, saqë një fis i tërë do të mund të ushqehen nga ajo. Dhe një dele do të japë aq shumë qumësht, saqë një familje e tërë do të mund të ushqehet me të. Atëherë, Allahu do të çojë një puhizë e cila do t’i qetësojë edhe nënsqetullat e tyre dhe do të marrë shpirtin e çdo muslimani. Vetëm njerëzit më të prishur do të mbeten dhe ata do të kryejnë marrëdhënie seksuale si gomarët. Pastaj, këtyre do t’ju vjen Çasti”. [Muslim]

### Hadithi i transmetuar nga Ebu Umameh el-Behilij

Ebu Umameh el-Bahilij tha se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] mbajti një ligjëratë, pjesa më e madhe e së cilës kishte të bënte me Dexhallin, dhe na paralajmëroi kundër tij. Ai tha:

“Asnjë çrregullim në tokë s’do të jetë më i rëndë që prej krijimit të Ademit sesa çrregullimi i Dexhallit. Allahu asnjëherë s’ka dërguar një peygamber e të mos ketë paralajmëruar popullin e tij kundër Dexhallit. Unë jam peygamberi i fundit dhe ju jeni umeti i fundit. Dexhalli do të paraqitet mes jush dhe kjo është e pashmangshme. Nëse ai shfaqet ndërsa unë jam gjallë, do të luftojë kundër tij në emër të çdo muslimani. Por, nëse ai shfaqet pas meje, atëherë çdo person duhet të luftojë kundër tij për vetveten. Ai do të shfaqet në rrugën mes Sirisë dhe Irakut dhe do të bëjë shkatërrime djathtas e majtas. O robër të Allahut, kapuni për shtegun e Allahut! Do t’jua përshkruaj atë në mënyrën që asnjë peygamber s’e ka përshkruar. Ai në fillim do të thotë se është peygamber, por pas meje s’do të ketë peygamber. Pastaj, do të thotë ‘Unë jam zoti juaj’, por ju s’do ta shihni Zotin, derisa të vdisni. Dexhalli është me një sy, kurse Zoti juaj – i lavdëruar qoftë ai – s’është me një sy. Në ballin e tij do ta ketë të shkruar fjalën *kafir*, të cilën çdo musliman, qoftë i mësuar, qoftë analfabet, do të jetë në gjendje ta shohë. Ndër ato gjëra që ai do t’i sjellë do të jetë xheneti dhe xhehenemi që ai do të ofrojë. Por, ajo çka ai quan xhehenem, do të jetë xhenet; ajo çka ai quan xhenet, do të jetë xhehenem. Kushdo që hyn në xhehenemin e tij, le të kërkojë shpëtim te Allahu dhe t’i thotë ajetet e para të sures Kehf, dhe ai do të jetë i ftohët dhe i rehatshëm për të, ashtu siç u bë i ftohët dhe i rehatshëm zjarri për Ibrahimin. Ai do t’i thotë

një beduini: 'Çfarë mendon nëse ta ringjalli nënën dhe babën tënd, a do të dëshmosh se unë jam zoti yt?' Beduini do ta pohojë këtë dhe dy shejtanë do të marrin formën e babës dhe të nënës së tij dhe do të thonë: 'O biri im, pasoje atë, se ky është zoti yt'. Atij do t'i jepet fuqi mbi një person të cilin do ta ndajë në dysh me sharrë e pastaj do të thotë: 'Shikoni robin tim! Tash do ta ringjalli, por ai hala do të pohojë se ka një zot tjetër veç meje'. Allahu do ta ringjallë dhe ky njeri i lig [Dexhalli] do t'i thotë: 'Kush është zoti yt?' Personi do të përgjigjet: 'Zoti im është Allahu dhe ti je armiku i Allahut. Ti je Dexhalli. Pasha Allahun, unë kurrë s'kam qenë më i sigurt në këtë sesa sot'. Ebu Said tha se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë: 'Ky person do të ketë gradën më të lartë në xhenet nga umeti im'. Ebu Seid tha: 'Pasha Allahun, ne kurrë s'kemi menduar se ky person është tjetërkush pos Umer ibn el-Khatabit, derisa ai vdiq'.

El-Muharibij tha:

"Pjesë e çrregullimit të tij do të jetë fakti që ai do të kalojë nëpër një regjion populli i të cilit do ta mohojnë dhe asnjë nga bagëtitë e tyre s'do të mbeten gjallë. Pastaj do të kalojë nëpër regjionin tjetër populli i të cilit do ta besojë atë, dhe ai do ta urdhërojë qiellin të lëshojë shiun dhe tokën të nxjerrë frytet, dhe tufat e tyre do të kthehen nga kullosat më të majme sesa asnjëherë më parë, me ijët e zgjeruara dhe me gjinj të përplot qumësht. Ai do të kalojë nëpër çdo vend të botës, përveç Mekes dhe Medines, në të cilat kurrë s'do të hyjë, sepse aty do të ketë engjëj që ruajnë çdo portë të tyre me shpata jashtë këllëfit, derisa të mbërrij te el-Zerib el-Ahmer dhe të vendoset buzë kënetës së njelmët. Medina do të dridhet me tri dridhje, pas të cilave çdo munafik [hipokrit] do të lëshojë atë dhe ajo do të pastrohet nga e keqja ashtu siç pastrohet hekuri nga zgjyra. Ajo ditë do të quhet *Jeum el-Khalas* [Dita e Pastrimit]".

Umm Sherik bin Ebil-Akr tha: "O i Dërguar i Allahut, ku do të jenë arabët në atë kohë?" Ai u përgjigj:

"Atëkohë, ata do të jenë të pakët dhe shumica prej tyre do të jenë në *Bejt el-Makdis* [Palestinë], dhe imami i tyre do të jetë njeri i drejtë. Ndërsa imami i tyre do të ecën përpara për t'i udhëhequr në namazin e sabahut, Isa, biri i Merjemes, do të zbresë. Imami do të zbrapset për ta lënë Isën të udhëheqë namazin, por Isa do të vendosë dorën mes krahëve të këtij burri dhe do të thotë: 'Ec dhe udhëheq në namaz, se ikameti u thirr për juve'. Kështu, imami do të udhëheqë njerëzit në namaz dhe, pas kësaj, Isa [alejhi selam] do të thotë: 'Çele portën', dhe porta do të çelet dhe pas saj do të jetë Dexhalli me një mijë çifutë, secili prej tyre me shpatë dhe me mburojë. Kur Dexhallit të shohë Isën, do të nisë të tretet si kripa në ujë dhe do të ikë. Isa do të thotë: 'Ti do të mbetesh gjallë, derisa të të godasë me shpatën time'. Ai do ta zërë atë tek porta lindore e Luddit dhe do ta vrasë. Çifutët do të mposhtën me ndihmën e Allahut. Për ta s'do të ketë vend për

t'u fshehur. Ata s' do të mund të fshihen mbas asnjë guri, muri, kafshe apo ndonjë druri - përveç drurit *el-Gharkareh* - e të mos thuhet: 'O rob i Allahut! Këtu ka një çifut. Eja dhe vrite!'

Pejgamberi [salallahu alejhi ue salam] tha:

"Koha e Dexhallit do të jetë 40 vjet; një vjet si gjysmë viti, një vit si një muaj dhe një muaj si një javë. Ditët e mbetura do të kalojnë aq shpejt, saqë sikur ndonjëri prej jush të ishte tek portat e Medines, s' do ta mbërrinte portën tjetër para se binte nata". Dikush pyeti: "O i Dërguar i Allahut, si do të falemi në ato ditë të shkurtra?" Ai tha: "Llogaritni kohët e namazit në mënyrën e njëjtë që e bëni në këto ditë më të gjata dhe pastaj faluni".

Pejgamberi [salallahu alejhi ue salam] tha:

"Isa, biri i Merjemes, do të jetë udhëheqës i drejtë për umetin tim. Ai do të thyejë kryqin, do ta vrasë derrin dhe do ta shfuqizojë *khizjen* [tatimin e jomuslimanëve]. Ai nuk do ta mbledhë sadakanë, kështu që s' do të mbledhë dele e deve. Armiqësia dhe urrejtja e shoqishoqme do të zhduken. Çdo kafshë e dëmshme do të bëhet e padëmshme, në mënyrë që një djalë i vogël do të jetë në gjendje ta vendosë dorën e në gojën e gjarprit pa pësuar ndonjë dëm. Një çikë e vogël do të mund ta bëjë luanin të ikën nga ajo dhe një ujk do të shkojë mes deleve sikur të ishte një qen stani. Toka do të mbushet me drejtësi ashtu siç mbushet një vaskë me ujë. Njerëzit do të jetojnë në harmoni dhe vetëm Allahu do të adhurohet. Luftërat do të pushojnë dhe Kurejshëve do t'u hiqet autoriteti nga dora. Toka do të jetë si një legen i argjendit dhe do të prodhojë fryte aq shumë, saqë një grup njerëzish do të mblidhen për të ngrënë rrush apo një shegë dhe do të ngihen. Një dem do të kushtojë shumë, kurse një kali do të vlejë vetëm disa dërhëmë". Dikush pyeti: "Përse kali do të kushtojë aq lirë?" Ai tha: "Sepse do të lërojë tokën. Për tre vjet para se të paraqitet Dexhalli, njerëzit do të përjetojnë një uri të ashpër. Në vitin e parë, Allahu do të urdhërojë qiellin ta mbajë shiun dhe toka do të ndalë dy të tretat e fryteve të saj. Në vitin e tretë, Ai do të urdhërojë qiellin të mbajë krejt shiun dhe toka do të ndalë krejt frytet, kështu që kurrjë e gjelbër s' do të rritet. Çdo krijesë me thundra të çara do të vdesë, përveç çfarëdo Allahu". Dikush pyeti: "Si do të jetojnë njerëzit atëkohë?" Ai tha: "Duke thënë *la ilahe ila Allah, Allahu ekber, subhan Allah* dhe *el-Hamdu lil-lah*. Kjo do të jetë si ushqim për ta".

Pejgamberi [salallahu alejhi ue salam] tha: "Dexhalli do të vjen dhe një nga besimtarët do të niset drejt tij. Rojet e armatosura të Dexhallit do ta pyesin:

- Ku po shkon?
- Dua ta shoh atë që është paraqitur - do të thotë ai.

- Vriteni! – do të thonë disa prej tyre. Pastaj disa të tjerë do të thonë: "A nuk e ka ndaluar zoti juaj [dmth Dexhalli] të vrisni ndonjë pa lejen e tij?"

Kështu, ata do ta çojnë te Dexhalli dhe, kur besimtari ta shohë atë, do të thotë:

- O njerëz, ky është Dexhalli për të cilin na ka treguar Allahu!

Pastaj Dexhalli do të urdhërojë ta kapin atë dhe do ta plagosin në kokë si dhe do ta godasin në gjithë trupin, bile edhe në kokë e në bark. Dexhalli do ta pyes:

- A nuk beson në mua?

- Ti je Mesia i rrejshëm – do t'ia kthejë ai.

Dexhalli do të urdhërojë që ta presin me sharrë nga mesi i kokës deri ku ndahen këmbët, pastaj do të ecë mes dy copave të prera dhe do të thotë: "Çohu!" dhe personi do të çohet. Dexhalli do t'i thotë:

- A nuk beson në mua?

- Kjo vetëm se ma ka shtuar bindjen se ti je Dexhalli – do t'i përgjigjet besimtari.

Pastaj do të thotë: "O njerëz, ky s' do të mund të bëjë kështu me ndonjë tjetër pas meje".

Dexhalli do ta kapë për ta prerë atë, por hapësira mes qafës së tij dhe klavikulës do të shndërrohet në bakër dhe Dexhalli s' do të mund të bëjë gjë. Ai do ta kapë personin për këmbësh dhe për duarsh dhe do ta hedhë. Njerëzit do të besojnë se ai është hedhur në xhehenem, kurse ai do të jetë hedhur në xhenet". Pejgamberi tha: "Ai do të jetë martiri më i madh në sytë e Allahut, Zotit të botëve". [Muslim]

## Hadithi i el-Mughireh ibn Shu'beh

El-Mughire ibn Shu'beh tha: "Kurrkush s'e ka pyetur pejgamberin më shumë rreth Dexhallit sesa unë, dhe ia tha:

- Mos ki merak, sepse ai s' do të mund t'ju dëmtojë.
  - Por, po thonë se ai do të ketë shumë ushqim dhe pije – i thashë.
  - Ai është tepër i parëndësishëm në shikimin e Allahut për të pasur tërë atë.
- [Muslim]

El-Mughire ibn Shu'beh tha: "Kurrkush s'e ka pyetur pejgamberin më shumë rreth Dexhallit sesa unë". Njëri nga transmetuesit e pyeti: "Çka e ke pyetur?" el-Mughireh tha: "Thashë: Po thonë që Dexhalli do të ketë një kodër me bukë e me mish dhe një lum me ujë. Pejgamberi tha: "Ai është tepër i parëndësishëm në shikimin e Allahut për të pasur tërë këtë". [Muslim]

Nga këto hadithe mund të shohim se Allahu do t'i sprovtojë robërit e Tij nëpërmjet Dexhallit dhe nëpërmjet mrekullive të cilat ai do të mund t'i bëjë. Siç kemi përmendur më herët, Dexhalli do të urdhërojë qiellin të lëshojë shiun për ata që i binden atij dhe do të urdhërojë tokën të nxjerrë frytet, në mënyrë që bagëtitë e tyre ta hanë atë dhe tufat e tyre të kthehen të majme dhe me gjinjtë plot qumësht. Ata që e refuzojnë Dexhallin, do të përjetojnë thatësi dhe uri, njerëzit dhe bagëtitë do të vdesin ndërsa pasuria dhe

rezervat e ushqimit do të harxhohen. Njerëzit do ta pasojnë Dexhallin sikurse tufat e bletëve dhe ai do ta vrasë një të ri e do ta kthejë prapë në jetë. Kjo s'është ndonjë lloj magjie, por është diçka e vërtetë me çka Allahu do t'i sprovovë robërit e Tij nga fundi i kohës. Shumë do të humbasin dhe shumë do të udhëzohen nga këto gjëra. Ata që dyshojnë, do të mohojnë, por atyre që besojnë, do t'u shtohet besimi.

Ibn el-Kadi Ijad dhe të tjerët e interpretuan frazën **“Ai është tepër i parëndësishëm në shikimin e Allahut për të pasur tërë këtë”** me domethënien se Dexhalli është tepër i parëndësishëm për të pasur diçka që do ta çorientonte besimtarin e vërtetë, sepse ai qartësisht ai do të jetë i prishur e i lig. Edhe nëse ai sjell terror të madh, fjala *kafir* do të shihet qartë mes syve të tij. Një transmetim shpjegon se do të jetë e shkruar *Kef, Fa, Ra*, çka ne kuptojmë se do të jetë e shkruar dukshëm e jo në mënyrë abstrakte, siç thonë disa. Ai do të jetë me njërin sy qorr, të cilin do ta ketë të spikatur dhe të pështirë, dhe kjo është domethënia e hadithit: **“... si një kokërr rrushi që pluskon [në sipërfaqen e ujit]”**. Të tjera transmetime flasin se syri i ti do të jetë **“i turbullt, pa dritë në të”** apo **“si pështyma e bardhë në mur”**, dmth syri do të jetë i shëmtuar.

Disa transmetime thonë që është syri i tij i djathtë ai që do të jetë i verbër. Të tjerët e thonë këtë për të majtin. Ai mund të jetë edhe pjesërisht i verbër në të dy sytë apo mund të ketë të metë në të dy sytë. Ky interpretim mund të mbështetet nga hadithi i transmetuar nga et-Taberani, ku transmetohet se Ibn Abas thotë se pejgamberi kishte thënë:

**“Dexhalli është me flokë dredha-dredha dhe me lëkurë të bardhë. Koka e tij është si degë e një peme. Syri i tij i majtë është i verbër, kurse tjetri sy duket si një kokërr rrushi që pluskon”**.

Dikush mund të pyes, nëse Dexhalli do të përhapë aq shumë ligësi dhe pretendimit të tij se ai është një zot do t'i besojnë shumë njerëz, ndonëse ai qartësisht është gënjeshtar dhe krejt pejgamberët kanë paralajmëruar kundër tij, përse Kurani nuk e përmend atë me emër dhe nuk na paralajmëron për gënjeshttrat dhe për kokëfortësinë e tij?

Përgjigja:

1. Dexhallit i është referuar në ajetin: **« ... Ditën kur shenjat e qarta të Zotit tënd do të vijnë, asnjë shpirti s'do t'i bëjë dobi besimi në to, nëse s'ka besuar më herët dhe s'ka nxjerrë dobi nga besimi i tij ... »** [el-Enam 158]

Ebu Hurejre tha që pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

**“Ka tri gjëra të cilat, kur të shfaqen, kurrfarë të mirë s'do t'i sjellin shpirtit që beson në to, nëse s'ka besuar më herët dhe s'ka bërë punë të mira nëpërmjet besimit të tij. Ato janë: Dexhalli, Bisha dhe lindja e diellit në Perëndim”**.

2. Isa, biri i Merjemes, do të zbresë nga qielli dhe do ta vrasë Dexhallin, siç kemi treguar tashmë. Zbritja e Isës përmendet në ajetin:

« **Dhe ata thanë [me mburrje]: ‘Ne vramë Isën, birin e Merjemes, të Dërguarin e Allahut’, por ata as nuk e vranë, as nuk e kryqëzuan, por kjo vetëm u është dukur atyre. Ata që dallojnë rreth kësaj, janë përplot dyshim, pa dije të sigurt dhe vetëm supozojnë, se, me të vërtetë, ata nuk e vranë atë. Kurrsesi. Allahu e ngriti atë tek Vetja e Tij. Allahu është i plotfuqishëm, i urtë. Dhe s’ka asnjë nga pasuesit Librit veçse duhet të besojë në të para vdekjes së tij dhe në Ditën e Gjykimit ai do të dëshmojë kundër tyre » [en-Nisa, 157-9]**

Ne mendojmë që *tefsiri* [interpretimi] i këtij ajeti është se përemri “i tij” në frazën « **para vdekjes së tij** » i referohet Isës, dmth ai do të zbresë dhe pasuesit e Librit që dallonin lidhur me të, do të besojnë në të. Të krishterët pohuan se ai është hyjnor, kurse çifutët bënë një akuzë ofenduese ndaj tij, dmth e akuzuan se ai kishte lindur si rrjedhim i një kurvërie. Kur Isa të zbresë para Ditës së Gjykimit, ai do t’i ndreqë krejt këto dallime e rrena. Bazuar në këtë, referimi ndaj zbritjes së Mesisë Isa, po ashtu, përfshin dhe referencën ndaj Dexhallit [Mesisë së rrejshëm], i cili është e kundërta e Mesisë së vërtetë, sepse nganjëherë arabët i referohen njëres nga dy të kundërtat e jo tjetrës, por mendojnë në të dyja.

3. Dexhalli s’përmendet me emër në Kuran, sepse ai është i parëndësishëm. Ai pohon të jetë hyjnor, por s’është veçse një qenie njerëzore. Çështjet e tija janë tepër të ulëta për t’u përmendur në Kuran. Por, pejgamberët, nga besnikëria ndaj Allahut, i paralajmëruan popujt e tyre për Dexhallin dhe mrekullitë çrregulluese që ai do të sjellë. Mjafton për ne që t’i dimë transmetimet nga pejgamberët dhe transmetimet e shumta nga pejgamberi Muhamed [salallahu alejhi ue selam].

Dikush mund të argumentojë se Allahu e ka përmendur në Kuran Faraonin dhe pohimet e tij të rrejshme, si « **Unë jam Zoti juaj, më i larti** » [en-Naziat, 24] dhe « **O prijës! Unë s’di për ju ndonjë zot tjetër veç meje ...** » [el-Kasas, 38].

Kjo mund të shpjegohet me faktin që Faraoni dhe punët e tij ndodhën në të kaluarën dhe rrenat e tij i janë të qarta çdo besimtari. Kurse, Dexhalli hala ka për të ardhur, në të ardhmen, dhe do të jetë *fitne* dhe sprovë për krejt njerëzit. Pra, Dexhalli nuk përmendet në Kuran, sepse ai është i ulët/i neveritshëm. Dhe fakti mbi Dexhallin dhe rrenat e tij është i qartë dhe s’kanë nevojë për t’u theksuar më tej. Për shembull, kur pejgamberi u sëmure nga fundi i jetës së tij, ai deshi të shkruante një dokument që konfirmonte se Ebu Bekr do të ishte kalif pas tij, por hoqi dorë nga kjo ide dhe tha: “Allahu dhe besimtarët s’do të pranojnë tjetërkënd pos Ebu Bekrit”. Ai vendosi të mos shkruante dokumentin, sepse ai e dinte që Ebu Bekr gëzonte respekt te sahabët dhe ishte i sigurt se s’do të zgjidhnin dikë tjetër.

Ngjashëm, faktet rreth Dexhallit janë aq të qarta, saqë s'ka nevojë të përmenden në Kuran. Allahu nuk e ka përmendur Dexhallin në Kuran sepse Ai, më i larti, e di që Dexhalli s'do të jetë në gjendje t'i humbasë robërit e tij të vërtetë, por ai vetëm se do t'ua shtojë besimin, nënshtrimin ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, besimin në të vërtetën dhe refuzimin e pavërtetësisë.

Për këtë arsye, besimtari të cilin Dexhalli do ta mbizotërojë, do të thotë, kur ai ta ringjallë: "Pasha Allahun, kjo vetëm se ma ka shtuar bindjen se ti je gënjeshtari me një sy qorr për të cilin peygamberi ka treguar".

## Më shumë hadithe rreth Dexhallit

Peygamberi [salallahu alejhi ue selam] tha:

"Dexhalli do të shfaqet në një vend të quajtur Khurasan. Pasuesit e tij do të jenë njerëzit me fytyra si mburoja të shtypura".

Esma bint Jezid el-Ensarijeh tha se peygamberi kishte thënë:

"Gjatë tri vjetëve para ardhjes së Dexhallit, do të ketë një vit kur qielli do të mbajë një të tretën e shiut dhe toka do të ndalë një të tretën e fryteve. Në vitin e dytë, qielli do të mbajë dy të tretat e shiut dhe toka do të ndalë dy të treta e fryteve. Në vitin e tretë, qielli do të mbajë krejt shiun dhe toka do të ndalë krejt frytet, dhe kafshët do të vdesin. Kjo do të jetë sprovë më e madhe. Dexhalli do të sjellë një beduin dhe do t'i thotë:

- Çka nëse ta ringjalli devenë tënde? A do të pranosh së unë jam zoti yt?
- Po – do të përgjigjet beduini.
- Kështu, shejtanët do të marrin formën e devesë së tij, me gjinjtë plot [qumësht] dhe me gungën më të lartë. Pastaj, do të sjellë një burrë baba dhe nëna e të cilit do të kenë vdekur dhe do ta pyes:
- Çka nëse ta kthejë babën dhe vëllain në jetë? A do të pajtohesh se jam zoti yt?
- Po – do të përgjigjet burri.

Kështu, shejtanët do të marrin formën e babës dhe vëllait të tij. Pastaj, peygamberi shkoi për diçka dhe u kthye. Njerëzit u brengosën për atë që u tha ai. Ai qëndroi në prag dhe pyeti:

- Si është puna, Esma?
- O i Dërguar i Allahut, na tmerrove me atë çfarë the për Dexhallin.
- Me siguri që ai do të paraqitet. Nëse do të jem hala gjallë, do ta për ju, përndryshe, Allahu do të përkujdeset për çdo musliman në emër timin.
- O i Dërguar Allahut, në nuk pjekim brumin, derisa të jemi uritur, kështu që si do të jetë puna e besimtarëve atëkohë?

- Lavdërimi i Allahut që u mjafton banorëve të qiellit, do t'u mjaftojë edhe atyre.

Ebu Hurejre tha se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] tha:

“Çasti s’do të vjen, derisa muslimanët t’i luftojnë çifutët dhe t’i vrasin ata. Kur një çifutët të fshihet mbas një guri apo një druri, ai [guri, druri] do të thotë: ‘O Musliman! O rob i Allahut! Mbas meje është një çifut. Eja dhe vrite!’ Krejt drunjtë do ta bëjnë këtë, përveç drurit *el-Gharkad*, sepse ai është dru i çifutëve”.

[Ahmed]

## Mbrojtja nga Dexhalli

1. Kërkimi i strehimit nga çrregullimi i tij. Është vërtetuar në hadithe të vërteta se peygamberi kërkonte shpëtim te Allahu nga sprovat e Dexhallit në namazin e tij dhe e urdhëroi për këtë umetin e tij:

*Allahumme inne eudhu bike min adhabi xhehenem we min adhabil-kabr we min fitnetil-mahja'i uel-mamat we min fitnetil-mesihi-Dexhal.*

O Allah, kërkujmë mbrojtje te Ti nga dënimi i xhehenemit, nga dënimi i varrit, nga çrregullimet e jetës dhe vdekjes dhe nga çrregullimet e Mesisë së rrejshëm [Dexhallit].

Ky hadith u transmetua nga shumë sahabë, përfshirë Enesin, Ebu Hurejren, Aishen, Ibn Abas dhe Sa’d.

2. Mësimi përmendsh i ajeteve nga sureja Kehf. El-Hafidh edh-Dhehebi tha:

“Kërkimi i shpëtimit te Allahu nga Dexhalli u përmend në shumë hadithe *mutewatir* [që kanë shumë transmetues]. Një mënyrë për ta bërë këtë është të mësohen përmendsh dhjetë ajete nga sureja Kehf”.

Ebul-Dira transmetoi se peygamberi tha:

“Ka engjëj që qëndrojnë te portat e Medines. Në të s’mund të hyjë as ndonjë epidemi, as Dexhalli”. [el-Buhari, Muslim]

Ebu Bekr transmetoi se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] tha:

“Terrori i shkaktuar nga Dexhalli s’do të hyjë në Medine. Atëkohë, Medina do të ketë shtatë porta. Do të ketë dy engjëj që do të ruajnë çdo portë”. [Buhari] Enes



tha se peygamberi kishte thënë: "Dexhalli do të vjen të Medina dhe do ta gjejë me engjëj që e ruajnë atë. Në të s'mund të hyjë as epidemia, as Dexhalli, nëse do Allahu". [et-Tirmidhi, el-Buhari]

U vërtetu në hadithe *sahi* se Dexhalli s'do të hyjë në Meke apo në Medine, sepse do ta parandalojnë engjëjt të hyjë në këto dy shenjtore dhe ato janë të sigurta prej tij. Kur ai të ngre kampin tek kënetat e njelmët [*Sabkhat*] e Medines, ajo do të dridhet me tri dridhje dhe çdo hipokrit do të dalë për t'iu bashkuar Dexhallit. Në atë ditë, Medina do të pastrohet nga zgjyra dhe do të dëliret. Allahu e di më së miri.

## Jeta dhe veprat e Dexhallit

Dexhalli do të jetë njeri, i krijuar nga Allahu, për të qenë sprovë për njerëzit nga fundi i kohës. Shumë do të devijojnë nëpërmjet tij dhe shumë do të udhëzohen për shkak të tij. Vetëm gjynahqarët do të humbasin. El-Hafidh ibn Ali el-Eber, në librin e tij të historisë *et-Terikh* shkroi se kунja e Dexhallit do të jetë Ebu Jusuf.

Ebu Bekreh tha se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Prindërit e Dexhallit do të mbeten pa fëmijë për 30 vjet, pastaj do t'u lindë një fëmijë me një sy qorr. Ai do të jetë shumë i keq dhe do të shkaktojë çrregullime të mëdha. Kur ai të flejë, sytë e tij do të jenë të mbyllur, por zemra e tij do të jetë aktive". Pastaj ai përshkroi prindërit e tij:

"Babai i tij do të jetë një burrë i gjatë dhe masiv, më hundë të gjatë si sqep. Nëna e tij do të jetë një grua masive me gjinj të mëdhenj".

Ebu Bekreh tha:

"Dëgjuam se në Medine disa çifutëve u kishte lindur një fëmijë. El-Zubejr ibn el-Awam dhe unë shkruam për të parë prindërit e tij dhe vërejtëm se i përgjigjeshin përshkrimit që i kishte bërë peygamberi. Ne pamë një djalë që po rrezitej, të mbuluar me qebe, duke i folur vetvetes. I pyetëm prindërit e tij rreth tij dhe thanë: 'Ne kemi qenë pa fëmijë për 30 vjet, pastaj ky djalë me një sy qorr na lindi. Ai është shumë i keq dhe bën sherre të mëdha'. Kur dolëm, kaluam pranë djalit dhe ai na pyeti: 'Çfarë po bëni?' Thamë: 'A na dëgjoje?' Ai tha: 'Po. Kur unë fle, sytë e mi janë të mbyllur, por zemra ime është aktive'. Ai djalë ishte Ebu Sejjed". [Ahmed, et-Tirmidhi. Ky hadith është i dobët]

Siç kemi parë tashmë në hadithe të vërteta, Malik dhe të tjerët mendojnë se Ibn Sejjed s' ishte Dexhalli, por ishte një nga dexhallët e vogël. Më vonë, ai u pendua dhe pranoi Islamin. Allahu e di më së miri për zemrën dhe për punët e tij.

Dexhalli i madh është ai, që përmendet në hadithin e Fatima bint Kajs, të cilin ajo e transmeton nga peygamberi nga Temim ed-Darij dhe i cili përfshin tregimin e el-Xhesassesh.

Dexhallit do t'i lejohet të shfaqet nga fundi i kohës, mbasi që muslimanët të pushtojnë një qytet romak të quajtur Kostandinopojë. Në fillim, ai do të shfaqet në Isfahan, në një vend që njihet si lagja e çifutëve. Ai do të pasohet nga shtatëdhjetëmijë çifutë nga ai vend dhe të gjithë do të jenë të armatosur. Shtatëdhjetëmijë tatarë dhe shumë njerëz të tjerë nga Khurasani, po ashtu, do t'i bashkëngjiten atij. Së pari, ai do të paraqitet si një mbret tiran, pastaj do të pretendojë se është peygamber e pastaj se është një zot. Vetëm të paditurit më të mëdhenj do ta pasojnë atë. Të drejtët dhe të udhëzuarit nga Allahu do ta refuzojnë.

Ai do të nisë pushtimin e botës shtet për shtet, kala për kala, regjion për regjion, qytet për qytet. Asnjë vend s' do të mbetet i padëmtuar, përveç Mekes dhe Medines. Kohëzgjatja e tij në tokë do të jetë 40 ditë: një ditë si një vit, një ditë si një muaj, një ditë si një javë dhe pjesa e mbetur e ditëve si ditët normale, dmth do të qëndrojë afërsisht një vit e dy muaj e gjysmë. Allahu do t'i mundësojë shumë mrekulli, nëpërmjet të cilave kë do Ai, do ta humbasë, dhe besimi i besimtarëve do të shtohet. Zbritja e Isës, birit të Merjemes, do të ndodhë në kohën e Dexhallit, Mesisë së rrejshëm. Ai do të zbresë te minarja në Lindje të Damaskut. Besimtarët dhe robërit e vërtetë të Allahut do të mblidhen për ta mbështetur atë dhe Isa do t'i udhëheqë ata kundër Dexhallit, i cili asokohe do të jetë duke ikur për në *Bejt el-Makdis* [Jerusalem]. Ai do ta mbërrijë te *Akaba afik*. Dexhalli do të ikë nga ai, por Isa do ta zërë te porta e Luddit dhe do ta vrasë me shtizë në hyrje të tij. Ai do t'i thotë: "Më duhet të të godasë. Ti s' mund të më ikësh". Kur Dexhalli të përballet me të, do të fillojë të tretët si kripa në ujë. Kështu, Jezusi do ta vrasë me shtizë tek porta e Luddit dhe ai do të vdesë aty, siç tregojnë shumë hadithe të vërteta. Maxhma bin Xharijeh u transmetua të ketë thënë se kishte dëgjuar peygamberin të thotë:

*"I biri i Merjemes do ta vrasë Dexhallin tek porta e Luddit". [et-Tirmidhi]*

## Zbritja e Isës nga fundi i kohës

Abdullah ibn Amr tha se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Dexhalli do të shfaqet në umetin tim dhe do të mbetet 40 [nuk më kujtohet nëse ai mendoi 40 ditë, 40 muaj apo 40 vjet] Pastaj Allahu do të dërgojë Isën [alejhi selam], birin e Merjemes, i cili do t’i përngjajë Urweh ibn Mes’ud. Ai do ta gjuajë Dexhallin dhe do ta vrasë. Pastaj, njerëzit do të jetojnë për shtatë vjet, gjatë të cilave s’do të ketë armiqësi as mes dy personave. Pastaj, Allahu do të dërgojë një erë ftohët nga drejtimi i Sirisë, e cila do t’i marrë shpirtrat e secilit që do të ketë edhe piklën me të vogël të mirësisë në zemrën e tij. Edhe sikur dikush të hyjë në zemrën e një mali, era do ta mbërrijë atë dhe do t’ia marrë shpirtin. Vetëm njerëzit më të këqij do të mbeten. Ata do të jenë të shkujdesur porsì zogjtë, me cilësi të bishave dhe s’do të kenë kurrfarë konsiderate për të mirën a të keqen. Shejtani do t’u vijë atyre në formën e një njeriu dhe do të thotë: ‘A nuk do të më përgjigjeni?’ Ata do të thonë: ‘Për çfarë na urdhëron?’ Ai do t’i urdhërojë të adhurojnë idhujt dhe, pavarësisht kësaj, ata do të kenë furnizim me bollëk dhe do të çojnë një jetë të rehatshme. Pastaj, do t’i fryhet Surit dhe secili do të zgjasë kryet për të dëgjuar. I pari që do ta dëgjojë, do të jetë një burrë i cili do të jetë duke ndrequr koritën për devenë e tij. Ai dhe krejt të tjerët do të hidhen përtokë. Pastaj, Allahu do të zbresë një shi si vesa dhe trupat e njerëzve [të vdekur] do të nisin të rriten nga kjo. Pastaj, prapë do t’i fryhet Surit dhe njerëzit do të çohen dhe do të shikojnë përreth. Pastaj do të thuhet: ‘O njerëz, shkoni të Zoti juaj dhe jepni përgjegjësi’. Do të thuhet: ‘Sillni banorët e xhehenemit’. Do të pyetet: ‘Sa janë ata’. Përgjigja do të vjen: ‘Nëntëqindnëntëdhjetenëntë nga çdo njëmijë’. « **Atë ditë, fëmija do të plakët dhe Kërçi do të shpaloset** » [el-Kalem, 42] [Muslim]

Ebu Hurejre tha se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“I biri i Merjemes do të zbresë si një udhëheqës i drejtë. Ai do të thyejë kryqin dhe do t’i vrasë derrat. Paqja do të mbizotërojë dhe njerëzit do të shfrytëzojnë shpatat e tyre si drapë. Çdo bishë e dëmshme do të bëhet e padëmshme. Qielli do të zbresë shi me bollëk dhe toka do të nxjerrë bereqetet e saj. Një fëmijë do të luajë me një dhelpër dhe s’do të bëhet dëm. Një ujk do të kullojë së bashku me delet dhe luani me bagëti pa i dëmtuar ato”. [Ahmed]

Ebu Hurejre tha se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, padyshim që i biri i Merjemes do të zbresë mes jush si një udhëheqës i drejtë. Ai do të thyejë kryqin, do t’i vrasë derrat dhe do ta shfuqizojë xhizjen. Dhe do të ketë pasuri aq shumë, sa që kurrkujt s’do t’i bëhet vonë për të. Një sexhde e vetme në namaz do të jetë më e mirë sesa krejt bota me gjithë çfarë ka në të”. Ebu Hurejre tha: “Nëse doni, recitoni ajetin « **Dhe s’ka asnjë nga ithtarët e Librit veçse duhet të besojë në të para vdekjes së tij, dhe në Ditën e Gjykimit ai do të dëshmojë kundër tyre ...** » [en-Nisa, 159] [el-Buhari, Muslim]

Ebu Hurejre tha se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Pejgamberët janë si vëllezërit. Ata kanë nëna të ndryshme, por feja e tyre është një. Unë jam më i afërti nga krejt njerëzit ndaj Isës, biri i Merjemes, sepse s’ka tjetër pejgamber mes meje dhe atij. Ai do të vjen prapë dhe, kur ta shihni, do ta njihni. Ai është me gjatësi mesatare, me lëkurë me ngjyrë në të kuqe pak. Ai do të mbartë dy tesha dhe flokët e tij do të duken si të lagura. Ai do ta thyejë kryqin, do t’i vrasë derrat, do ta shfuqizojë xhizjen dhe do t’i thërrasë njerëzit në Islam. Gjatë kohës së tij, Allahu do t’i japë fund çdo feje e çdo sektit tjetër veç Islamit dhe do ta shkatërrojë Dexhallin. Pastaj, në tokë do të mbizotërojnë paqja dhe siguria, sa që luanët do të kullosin me devetë, tigrat me bagëtinë dhe ujqit me delet. Fëmijët do të mund të luajnë me gjarpërinj pa pësuar ndonjë dëm. Isa do të mbetet për 40 vjet e pastaj do të vdesë dhe muslimanët do t’ia falin xhenazen”. [Ahmed]

Ibn Mesud tha se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Në natën e Israsë [udhëtimit të natës], takova babanë tim Ibrahimin, Musën e Isën dhe ata po diskutonin Çastin. Së pari, çështja iu drejtua Ibrahimit, pastaj Musës dhe të dy thanë: ‘Nuk di rreth kësaj’. Pas kësaj, do t’i referohet Isës, i cili tha: ‘Kurrkush nuk di për kohën e tij, përveç Allahut. Ajo çfarë më ka thënë Allahu është se Dexhalli do të shfaqet dhe, kur ai të më shohë, do të nisë të shkrihet si plumbi. Allahu do ta shkatërrojë atë, kur ai të më shohë. Muslimanët do të luftojnë kundër kafirave e bile edhe pemët dhe gurët do të thonë: ‘O musliman, një kafir po fshihet nën mua. Eja dhe vrite!’ Allahu do t’i shkatërrojë kafirat dhe njerëzit do të kthehen në tokat e tyre. Pastaj, do të shfaqen Jexhuxhët e Mexhuxhët nga të gjitha anët, duke ngrënë e pirë gjithçka që gjejnë. Njerëzit do të më ankohen dhe unë do t’i lutem Allahut e Ai do t’i shkatërrojë. Kështu, toka do të mbushet me kundërmimin e tyre. Allahu do të zbresë një shi i cili do të çojë trupat e tyre në det. Zoti im më ka thënë se, kur kjo të ndodhë, Çasti do të jetë shumë afër, si gruaja shtatzënë të cilës i ka ardhur koha, por familja e saj nuk e di saktë kohën kur do të lindë”. [Ahmed, Ibn Maxheh]

## Përshkrim i Mesisë Isa, birit të Merjemes, të Dërguarit të Allahut

Ebu Hurejre tha se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Në natën e Israsë, takova Musën. Ai ishte një burrë i hollë, me flokë valore, dhe i përngjante një burrë nga fisi Shenu’e. Po ashtu, takova Isën. Ai ishte me gjatësi mesatare dhe me çehre të kuqe, sikur sapo të kishte dalë nga banja”. [Buhari, Muslim]

Pejgamberi [[salallahu alejhi ue selam] tha:

“Ndërsa po flija, pashë veten [në ëndërr] duke bërë tawaf Qaben. Pashë dhe një burrë me lëkurë bojëkafe, me flokë të drejta, të mbështetur në dy burra tjerë, dhe flokët i pikonin ujë”. Thashë: “Kush është ky?” Thanë: “I biri i Merjemes”. U ktheva në anën tjetër dhe pashë një burrë të trashë, faqekuq, me flokë dredha-dredha, i cili ishte qorr në syrin e djathtë; syri i tij dukej si një kokërr rrushi që pluskon. Pyeta: “Kush është ky?” Thanë: “Dexhalli”. Ai që më së shumti i përngjan atij, është Ibn Ketan”.

El-Zuhri shpjegoi: “Ibn Ketan ishte një njeri nga Khuzah, i cili vdiq gjatë xhahilijetit [para ardhjes së Islamit]” [el-Buhari]

## Shfaqja e Jexhuxhëve e Mexhuxhëve

Ata [dy fiset apo popujt] do të shfaqen gjatë kohës së Isës, birit të Merjemes, mbas Dexhallit. Allahu do t'i shkatërrojë ata të gjithë brenda një nate në përgjigje të lutjes së Isës. Ebu Hurejre transmetoi se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Çdo ditë, Jexhuxhët e Mexhuxhët përpiqen të gërmojnë një shteg tejpërtej digës [pengesës]. Kur ata shohin dritën e diellit nëpërmjet saj, ai që është në krye të tyre, thotë: 'Kthehuni! Nesër mund të vazhdoni gërmimin'. Kur ata kthehen, diga është edhe më e fortë sesa ishte më parë. Kjo do të vazhdojë, derisa t'u vjen koha atyre dhe Allahu dëshiron t'i qesë jashtë ata. Ata do të gërmojnë, derisa të nisin të shohin dritën e diellit. Atëherë, ai që është në krye të tyre, do të thotë: 'Kthehuni! Nesër mund të vazhdoni gërmimin, inshaAllah'. Në këtë rast, ai do të bëjë përjashtim duke thënë 'inshaAllah', duke ia lënë këtë çështje vullnetit të Allahut. Ata do të kthehen ditën e nesërme dhe do ta gjejnë birën ashtu siç e lanë. Ata do të vazhdojnë gërmimin dhe do të dalin kundër njerëzve. Ata do të pinë krejt ujin ndërsa njerëzit do të strehohen në kalatë e tyre. Jexhuxhët e Mexhuxhët do t'i hedhin shigjetat e tyre drejt qiellit dhe ato do të bien në tokë me diçka si gjak në to. Jexhuxhët e Mexhuxhët do të thonë: 'I mposhtëm banorët e tokës dhe të qiellit'. Pastaj Allahu do të çojë një lloj krimbi në gropën e zverkut [qafës] të tyre dhe ata do të vriten nga kjo. Pasha Atë, në dorën e të cilit është shpirti i Muhamedit, bishat e tokës do të trashen. Jexhuxhët e Mexhuxhët janë dy grupe turqish, pasardhës të Jafethit, babait të turqve, njërit nga bijtë e Nuhut [alejhi selam]. Në kohën e Ibrahimit [alejhi selam], ishte një mbret i quajtur Dhul-Karnejn. Ai e bëri tawaf Qaben me Ibrahimin, kur ai e ndërtoi atë së pari; ai i besoi dhe e pasoi atë. Dhul-Karnejn ishte një njeri i mirë dhe një mbret i madh. Allahu i dha pushtet të madh dhe ai sundoi Lindjen e Perëndimin. Ai kishte nën këmbë krejt mbretërit dhe krejt vendet, dhe udhëtoi gjerë e gjatë në Perëndim e në Lindje. Ai udhëtoi në Lindje, derisa zateti një kalim mes dy kodrash, nëpërmjet së cilës dilnin një popull. Ata nuk kuptonin gjë, sepse ishin të izoluar; ata ishin Jexhuxhët e Mexhuxhët. Ata po bënë çrregullime gjithandej tokës dhe po u bënë zullum njerëzve, kështu që njerëzit lypën ndihmë nga Dhul-Karnejn. Ata e lutën atë të ndërtonte një pengesë [digë] mes tyre e Jexhuxhëve e Mexhuxhëve. Ai u kërkoi atyre t'i ndihmonin atij dhe ata së bashku ndërtuan një

digë duke përzier hekurin, bakrin dhe katranin. Kështu, Dhul-Karnejn i zaptoi Jexhuxhët e Mexhuxhët mbas digës. Ata u përpoqën të depërtonin tej përtej digës, por nuk ia dolën. Ata nuk mund ta kalojnë, sepse diga është e stërmadhe dhe e lëmuar. Ata vazhduan të gërmonin dhe kanë qenë duke gërmuar për shekuj me radhë, dhe do të vazhdojnë gërmimin, deri atëherë kur Allahu të ketë caktuar që ata të dalin. Atëkohë, diga do të rrëzohet dhe Jexhuxhët e Mexhuxhët do të ngarendin në të gjitha anët, duke bërë zullum, duke i shkukur bimët [drunjte] e duke vrarë njerëz. Kur Isa [alejhi selam] të lutet kundër tyre, Allahu do të çojë një lloj krimbi në zverkun e tyre dhe ata do të vriten nga kjo".

## Shkatërimi i Qabes

Nga fundi i kohës, Dhul-Suwejkatejn, i cili do të vjen nga Abisinia [el-Habesh], do ta shkatërrojë Qaben, me qëllim që ta grabisë thesarin e saj dhe *kiswan* [mbulesën e Qabes]. Qabja është një ndërtesë e lashtë, e ndërtuar nga Ibrahim, themelet e së cilës qenë vënë nga Ademi [alejhi selam]. Siç thuhet në tefsirin e ajetit « **Derisa Jexhuxhët e Mexhuxhët të lëshohen [t'u hiqet pengesa]** » [el-Enbija, 96] nga Kab el-Ahbar se Dhul-Suwejkatejn së pari do të shfaqet gjatë kohës së Isës, birit të Merjemes.

Allahu do të dërgojë Isën si udhëheqës të një pararoje të përbërë mes 700 e 800 vetëve. Ndërsa ata marshojnë drejt Dhul-Suwejkatejn, Allahu do të dërgojë një fllad nga drejtimi i Jemenit, i cili do t'i marrë shpirtrat e besimtarëve. Do të mbetem vetëm njerëzit më të këqij, të cilët do të bëjnë marrëdhënie seksuale si kafshët. Kab tha: “Atëkohë, Çasti do të jetë fare pranë”. Abdullah ibn Amr tha: “Dëgjova pejgamberin [salallahu alejhi ue selam] të thotë:

“Dhul-Suwejkatejn nga Abisinia do ta shkatërrojë Qaben dhe do ta grabisë thesarin e *kiswan* e saj. Sikur po e shoh tani: ai është tullac dhe ka një defekt në kyçin e dorës. Ai do ta godasë Qaben me lopatën e me kazmën e tij”. [Ahmed]

Qe transmetuar nga Abdullah ibn Umer se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Lini rehat Abisinët për sa kohë që s’ju trazojnë, se kurrkush pos Dhul-Suwejkatejnit të Abisnisë s’do të zbulojë thesarin e Qabes”. [Ebu Daud, në kaptinën e ndalimit të provokimit ndaj Abisinëve].

Ibn Abas transmetoi se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Sikur po e shoh tash: ai është i zi dhe këmbët i ka konsiderueshëm të larguara nga njëra-tjetra. Ai do ta shkatërrojë Qaben gur për gur”. [Ahmed]

Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] tha:

“Çasti s’do të vjen, derisa të paraqitet një burrë nga Khatani dhe t’i sundojë njerëzit”. [Muslim. Ka hadith të ngjashëm në Buhari]



Ky burrë mund të jetë Dhul-Suwejk, një tjetër person, sepse ky vjen nga Kahtani, kurse transmetimet tjera thonë që Dhul-Suwejkatejn vjen nga Abisinia. Allahu e di më së miri. Ebu Hurejre tha se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Ditës e natës s’do t’i vjen fundi, derisa një burrë i liruar, i quajtur Jahja, të marrë pushtetin”. [Ahmed]

Ky mund të jetë emri i Dhul-Suwejkatejn nga Abisinia dhe Allahu e di më së miri. Umer ibn el-Khatab transmetoi se kishte dëgjuar pejgamberin [salallahu alejhi ue selam] të thotë:

“Banorët e Mekes do të largohen dhe vetëm një pakicë njerëzish do ta kalojnë përmes saj. Pastaj, ajo do të rindërtohet dhe pastaj prapë njerëzit do të largohen dhe kurrkush kurrë më s’do të kthehet”.

Është dëshmuar në hadithe *sahi* se Dexhalli s’do të mund të hyjë në Meke e në Medine, dhe se do të ketë engjëj te portat e Mekes, të cilët do ta pengojnë nga hyrja. Qe transmetuar se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

“Në Medine s’mund të hyjë as Dexhalli e as ndonjë epidemi”.

Siç u përmend më herët, Dexhalli do të ngrejë kampin në dalje të Medines dhe ajo do të dridhet tri herë. Çdo hipokrit e gjynahqarë do të dalë për t’iu bashkuar Dexhallit dhe çdo besimtar do të rrijë në të. Kjo ditë do të quhet Dita e Dëllirjes. Shumica e atyre që do të dalin për t’iu bashkuar Dexhallit, do të jenë gra. Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] tha:

“Vërtet, ajo [Medina] është e mirë. E keqja e saj do të mënjanohet, kurse e mira e saj do të jetë e qartë”.

Allahu i lartësuar thotë:

« Gratë e shthurura janë për burrat e shthurur dhe burrat e shthurur janë për gratë e shthurura; gratë e dëlira janë për burrat e dëlirë dhe burrat e dëlirë janë për gratë e dëlira » [el-Nur, 24-26]

Medina do të jetë e banueshme gjatë ditëve të Dexhallit si dhe gjatë ditëve të Isës [alejhi selam], derisa ai të vdesë dhe të varroset aty. Pastaj, do të shkatërrohet. Umer ibn el-Khatab tha: Dëgjova pejgamberin [salallahu alejhi ue selam] të thotë:

“Një kalorës do të kalojë nëpër Medine dhe do të thotë: ‘Dikur, këtu ka pasur shumë muslimanë’”. [Ahmed]

## Shfaqja e Bishës

Ndër shenjat e Çastit do të jetë edhe shfaqja e një Bishë nga toka. Ajo do të ketë pamje të çuditshme dhe do të jetë e stërmadhe. Njeriu s'mund as të imagjinojë se si do të jetë ajo. Ajo do të dalë nga toka duke e shkundur pluhurin nga kryet. Me vete do të ketë Unazën e Sulejmanit [alejhi selam] dhe Shkopin e Musës [alejhi selam]. Njerëzit do të tmerrohen prej saj dhe do të mundohen të ikin, por s'do t'ia dalin, sepse i tillë do të jetë caktimi i Allahut. Ajo do të prishë me shkop hundën e çdo mosbesimtari dhe do të shkruajë fjalën "kafir/mosbesimtar" në ballin e tij; do të zbukurojë fytyrën e çdo besimtari dhe do të shkruajë fjalën "mu'min/besimtar" në ballin e tij, dhe do t'u flasë njerëzve. Allahu i patëmeta thotë:

**« Dhe, kur Fjala të jetë përmbushur kundër tyre [të padrejtëve], Ne do t'ua nxjerrim atyre nga toka një Bishë dhe ajo do t'u flasë atyre ... »** [en-Neml, 82]

Ibn Abbas, el-Hasan dhe Kutadeh thanë se « ... **ajo do t'u flasë atyre ...** » do të thotë se ajo do t'u mbajë fjalim atyre. Ibn Xherir sugjeroi se kjo do të thotë që Bisha do t'u drejtohet njerëzve me fjalët « ... **ngaqë njerëzimi nuk ishin të bindur në Shenjat Tona ...** » [en-Neml, 82; pjesa e fundit e ajetit]

Ibn Xherir transmetoi këtë nga Ali dhe nga 'Ata. Qe transmetuar nga Ibn Abas se « ... **ajo do t'u flasë atyre ...** » do të thotë se Bisha do t'i presë ata, dmth do të shkruajë fjalën "kafir" në ballin e mosbesimtarit. Po ashtu, që transmetuar nga Ibn Abas se ajo edhe do t'ju flasë, edhe do t'i presë. Ky mendim përfshin të dyja sugjerimet e mëhershme, dhe Allahu e di më së miri. Tashmë përmendëm hadithin e Hudhejfe ibn Usejd, ku peygamberi [salallahu alejhi ue selam] tha:

*"Çasti s'do të vjen, derisa t'i shihni dhjetë shenja: Tymi, Dexhalli, Bisha, lindja e diellit në Perëndim, zbritja e Isës, birit të Merjemes; Jexhuxhët e Mexhuxhët, dhe tri rrëshqitjet e tokës – njëra në Lindje, njëra në Perëndim dhe njëra në Arabi, në fund të të cilave zjarri do të shpërthejë nga drejtimi i Adenit [Jemen] dhe do t'iu grahë njerëzve për te vendi i tubimit të tyre".*

Ebu Hurejre tha se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Ngutuni të bëni punë të mira, para se të ndodhin gjashtë gjëra: lindja e diellit në Perëndim, Tymi, Dexhalli, Bisha, vdekja juaj apo çrregullimi i përgjithshëm".  
[Muslim]

Berideh tha: "Pejgamberi më çoi te një vend në shkretëtirë, afër Mekes. Aty ishte një truall i rrethuar me zall. Ai më tha: 'Bisha do të shfaqet nga ky vend'. Ajo ishte një hapësirë shumë e vogël". [Ibn Maxheh]

Qe transmetuar nga Ebu Hurejre se Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Bisha e tokës do të shfaqet dhe me vete do të ketë Shkopin e Musës dhe Unazën e Sulejmanit".

Po ashtu qe transmetuar të ketë thënë:

"Bisha do të prishë hundët e mosbesimtarëve me Unazë [deri në atë masë], sa që njerëzit e ulur rreth një tavoline do t'i drejtohen shoqi-shoqit me fjalët "O besimtar!" apo "O mosbesimtar!" [Dmth gjendja e secilit do të dihet] [Ibn MAXheh]

Abdullah ibn Amr tha: "Kam mbajtur në mend një hadith të pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] e kurrë s'e kam harruar. Dëgjova pejgamberin të thotë:

'Shenja e parë që do të shfaqet do të jetë lindja e diellit në Perëndim dhe shfaqja e Bishës paradite. Cilado nga këto dyja që ndodh e para, tjetra do të pasojë menjëherë'". [Muslim]

Domethënë, këto do të jenë shenjat e para të jashtëzakonshme. Dexhalli, zbritja e Isës [alejhi selam], shfaqja e Jexhuxhëve dhe e Mexhuxhëve janë më pak të çuditshme në atë se këto janë qenie njerëzore. Kjo [Bisha] është shenja e parë tokësore, ndërsa lindja e diellit në Perëndim është e para nga shenjat qiellore.

## Lindja e Diellit në Perëndim

Allahu i patëmëta thotë:

« **A po presin ata t'i shohin engjëjt tek u vijnë apo vetë Zoti, apo ndonjë nga Shenjat e Zotit tënd? Dita kur të vijnë Shenjat e Zotit tënd s'do t'i sjellë kurrfarë të mire shpirtit që nuk ka besuar më herët dhe s'ka bërë punë të mira nga besimi. Thuaj: 'Pritni, se edhe ne po presim'** » [el-En'am, 158]

Qe transmetuar nga Ebu S'eid el-Hudri se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte shpjeguar ajetin « **Dita kur të vijnë Shenjat e Zotit tënd s'do t'i sjellë kurrfarë të mire shpirtit që nuk ka besuar më herët** » se kjo është lindja e diellit në Perëndim. [Ahmed]

Ebu Hurejre tha se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Çasti s'do të vjen, derisa të lindë dielli në Perëndim. Kur njerëzit ta shohin këtë, do të besojnë të gjithë ata që jetojnë në tokë, por kjo do të jetë koha kur « **kurrfarë të mire s'do t'i sjellë shpirtit që nuk ka besuar më herët** » " [el-Buhari]

Gjithashtu, qe transmetuar nga Ebu Hurejre se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"**Ka tri gjëra të cilat, nëse ndodhin, « ... s'do t'i sjellë kurrfarë të mire shpirtit që nuk ka besuar më herët dhe s'ka bërë punë të mira nga besimi » Ato janë: lindja e diellit në Perëndim, Dexhalli, dhe Bisha e tokës**". [Ahmed, Muslim, et-Tirmidhi]

Ebu Dherr tha: "Peygamberi [salallahu alejhi ue selam] më pyeti: "**A e di ku shkon dielli, kur perëndon?**" Thashë: "Nuk e di". Ai tha: "**Ai udhëton, derisa të bjerë në sexhde nën Fronin dhe kërkon leje për t'u ngritur prapë. Por, do të vjen koha kur do t'i thuhet: 'Kthehu nga erdhe'**". Kjo do të jetë koha kur « **s'do t'i sjellë kurrfarë të mire shpirtit që nuk ka besuar më herët dhe s'ka bërë punë të mira nga besimi** » " [el-Buhari]

Amr ibn Xherir tha: "Tre muslimanë po rrinin ulur me Meruanin në Medine, të cilin e dëgjova të thoshte, ndërsa po fliste për Shenjat e Çastit, se e para prej tyre do të jetë shfaqja e Dexhallit. Ata të tre shkuan te Abdullah ibn Amr dhe i treguan çka kishin dëgjuar Meruanin të thoshte lidhur me Shenjat. Abdullah tha: "Meruani s'ka treguar shumë. Unë e kam mbajtur në mend një hadith si ky nga peygamberi [salallahu alejhi ue selam]

selam]: "Shenja e parë do të jetë lindja e diellit në Perëndim, pastaj shfaqja e Bishës paradite. Cilado nga këto dyja që ndodh e para, tjetra do të pasojë menjëherë".

Pastaj, Abdullahu, i cili ishte kishte njohuri të thella, tha: "Mendoj që e para që do të ndodhë është lindja e diellit në Perëndim. Sa herë që dielli perëndon, shkon nën Fronin, bie në sexhde dhe kërkon leje për t'u ngritur prapë. Do të vjen koha kur do të kërkojë leje tri herë dhe s'do të marrë përgjigje, derisa, kur të ketë kaluar një pjesë e natës dhe kuptojë se, edhe sikur t'i jepej leje, nuk do të lindte me kohë, do të thotë: 'O Zoti im, sa e kam larg ngritjen! Çfarë mund të bëjë për njerëzit tash?' Pastaj, do të kërkojë leje të kthehet mbrapa dhe do t'i thuhet: 'Ngrihu prej aty ku je tash', dhe do të ngrihet në Perëndim". Pastaj Abdullahu recitoi ajetin «... **s'do t'i sjellë kurrfarë të mire shpirtit që nuk ka besuar më herët dhe s'ka bërë punë të mira nga besimi** » [Ahmed]

## Tymi i cili do të shfaqet nga fund i kohës

Mesruk tha: "Ndërsa një burrë po u mbante fjalim banorëve të Kindes, tha: 'Do të ketë Tym në Ditën e Ringjalljes, i cili do t'ua marrë hipokritëve dëgjimin dhe të parët, kurse besimtarët do të ndjejnë sikur janë të ftohur'. Në u tmerruam, kështu që shkuam te Ibn Mes'ud, i cili po rrinte mbështetur. Kur dëgjoi për këtë, u hidhërua shumë dhe u ul e tha: 'O njerëz, kushdo që di diçka, le ta thotë; kushdo që s'di, le të thotë 'Allahu e di më së miri'. Është pjesë e dijes që, kur personi të mos dijë diçka, të thotë 'Allahu e di më së miri'".

Allahu i patëmeta i tha peygamberit [salallahu alejhi ue selam]:

« **Thuaj: 'Nuk kërkoj për këtë [Kuran] kurrfarë shpërblimi e as nuk shtirem »**  
[Sad, 38-86]

"Kurejshët po tregoheshin të ngadaltë në pranimin e Islamit, kështu që peygamberi [salallahu alejhi ue selam] u lut kundër tyre duke thënë: '**O Allah, më ndihmo kundër atyre duke dërguar shtatë vjet uri si ato të Jusufit**'. Ata u goditën nga një vit urie në të cilin gati u shkatërruan dhe hanin cofëtina e eshtra. Ata nisën të shihnin diçka si tym mes qiellit dhe tokës. Ebu Sufjan erdhi dhe tha: 'O Muhamed, ti erdhe të na urdhërosh për marrëdhënie të mira me të afërmit, kurse populli po mbaron. Lutu që Allahu t'u ndihmojë atyre'. Atëherë, Ibn Mes'ud recitoi:

« **Pritni Ditën kur qielli të sjellë një tym [mjegull] të dukshëm, i cili do t'i mbështjellë njerëzit. Ky do të jetë një dënim të rëndë. [Ata do të thonë] 'Zoti ynë! Na e largo këtë dënim, se ne vërtet po besojmë! E si të përfitojnë ata nga Shpallja, kur u pat ardhur i Dërguari t'ua shpjegojë gjërat qartë, kurse ata ia kthyen shpinën duke thënë: 'I mbikëqyrur [nga dikush tjetër], i xhindosur! Ne vërtet që do ta largojnë dënimin për një kohë, por ju do të ktheheni prapë [në rrugët tuaja]' »** [ed-Dukhan, 10-15]

Ibn Mes'ud tha: "A do të largohet dënimi prej tyre në ahiret që ata të kthehen në mosbesimin e tyre?" Allahu i patëmeta thotë:

« **Ditën kur Ne do t'i kapim me një dënim të ashpër. Vërtet, ne do të marrim hak »** [ed-Dukhan, 16]

« **... së shpejti do të vjen e pashmangshmja [dënimi] »** [el-Furkan, 77]

Këto ajete i referohen Ditës së Bedrit. Allahu i lartësuar thotë:

**« Elif-Lam-Mim. Romakët u mposhtën në një vend të afërt, por ata, mbas kësaj disfate, së shpejti, brenda disa viteve, do të dalin fitimtarë »** [er-Rum, 1-3] [el-Buhari]

Sugjerimi i folësit - se Tymi do të ndodhë në Ditën e Ringjalljes – e hidhëroi Ibn Mes'udin. Pra, Tymi do të shfaqet para Ditës së Ringjalljes. Ai do të jetë një nga Shenjat: Bisha, Dexhalli, Tymi, Jexhuxhët e Mexhuxhët, siç tregojnë hadithet e transmetuara nga Ebu Sariha, nga Ebu Hurejre dhe nga sahabë të tjerë. Siç përmendet në hadithe të vërteta, zjarri i cili do të shfaqet para Ditës së Ringjalljes, do të shpërthejë nga drejtimi i Adenit dhe do t'u grahë njerëzve për tek tubimi përfundimtar i tyre. Ai do lëvizë me ta dhe do të ndalet me ta, dhe do të përpijë këdo që mbetet mbrapa.

## Çasti nuk do të ndodhë, derisa ...

Qe transmetuar nga Ebu Se'id el-Khudri se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Me afrimin e Çastit, rrufetë do të shtohen deri në atë masë, saqë, kur dikush të takohet me njerëz, do të pyesë: 'Kush prej jush u godit nga rrufeja sot në mëngjes?', dhe do të thonë: 'Filani e filani u goditën'". [Ahmed]

Po ashtu, qe transmetuar nga Ebu Hurejre se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Çasti s'do të vjen, derisa të ndodhin reshje të cilat do të shkatërrojnë gjithçka, përveç tendave".

Tashmë kemi përmendur shumë hadithe rreth shenjave të Çastit. Tash, do të përqendrohemi në disa hadithe të cilat tregojnë se Çasti është fare pranë.

Qe transmetuar nga Ebu Hurejre se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Çasti s'do vjen, derisa të ndodhin ngjarjet në vijim:

- njerëzit do të bëjnë garë mes vete në ndërtimin e ndërtesave të mëdha;
- dy grupime të mëdha do ta luftojnë njëra-tjetrën dhe do të ketë shumë viktima – të dyja palët do të jenë pasues të mësimëve të njëjta fetare;
- do të shtohen tërmetet;
- koha do të kalojë shpejt;
- do të shtohen vrasjet dhe vuajtjet;
- do të shfaqen afërsisht tetëdhjetë dexhallë dhe secili prej tyre do të pohojë se është i Dërguar i Allahut;
- një person do të kalojë pranë një varri dhe do të thotë: 'Sikur të isha në vendin tënd!';
- dielli do të lindë në Perëndim dhe, kur të lindë e njerëzit ta shohin këtë, krejt do të besojnë, por kjo do të jetë koha kur « **S'do t'i bëjë dobi shpirtit që s'ka besuar më herët ...** » [el-En'am, 158];
- pasaniku do të shqetësohet se mos nuk po gjen njeri t'i japë zekatin". [el-Buhari, Muslim]

Qe transmetuar nga Enes se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:



"Ndër shenjat e Çastit janë këto në vijim:

- dija [fetare] do të pakësohet, kurse injoranca do të mbizotërojë;
- kurvëria dhe pirja e alkoolit do të jenë të zakonshme;
- numri i burrave do të pakësohet, kurse numri i grave do të shtohet aq shumë, sa që një burrë do të mbetet për pesëdhjetë gra". [el-Buhari]

Aisha tha se kishte dëgjuar pejgamberin [salallahu alejhi ue selam] të thotë:

"Dita e nata s'do të mbarojnë, derisa njerëzit të fillojnë të adhurojnë Latin e Uzzanë [dy idhujt e Arabisë para-islamike]". Unë thashë: "O i Dërguar i Allahut, kam menduar se, kur Allahu shpalli ajetin « **Është Ai që dërgoi të Dërguarin e vet me udhëzim dhe me fe të vërtetë për të mbizotëruar ndaj krejt feve, edhe pse paganët e urrejnë këtë** » [et-Teubeh, 33], kjo do të përmbushet". Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] tha: "Do të ndodhë siç do Allahu. Pastaj Allahu do të dërgojë një fllad, i cili do të marrë këdo që ka besim në zemrën e tij sa kokrra e mustardës. Vetëm ata të cilët s'kanë kurrfarë të mire në veten e tyre, do të mbeten, dhe ata do t'i kthehen fesë së paraardhësve të tyre". [Muslim]

Nga Ebu Hurejre se një ditë prej ditësh, ndërsa pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] po rrinte ulur me disa njerëz, erdhi një beduin dhe e pyeti rreth imanit dhe islamit, pastaj pyeti:

- O i Dërguar i Allahut, kur do të ndodhë Çasti?
- **Ai që u pyet, nuk di më shumë se ai që po pyet, por po të tregoj për shenjat e tij. Kur një robëreshë të lindë zonjën e vet dhe kur këmbëzbathurit dhe të zhveshurit të bëhen udhëheqës të njerëzve – këto janë ndër shenjat e Çastit. Ka pesë gjëra të cilat s'i di kush pos Allahut",** pastaj recitoi: « **Vërtet, kohën e ndodhjes së Çastit s'e di kush pos Allahut. Është Allahu Ai që e zbret shiun dhe Ai që e di çka mbajnë mitrat. Kurrkush nuk di se çfarë do t'i ndodhë nesër dhe ku do të vdesë. Vërtet, Zoti është i gjithëdijsëm** » [Lukman, 34].

Pastaj burri u largua, dhe pejgamberi tha: "Ma thirrni prapë atë", por, kur njerëzit iu vunë pas për ta thirrur, nuk panë gjë. Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] tha: "Ai ishte Xhibrili. Erdhi t'ua mësojë njerëzve fenë e tyre". [el-Buhari, Muslim]

"Varfanjakët këmbëzbathur e të zhveshur do të bëjnë garë në ndërtimin e ndërtesa të larta" do të thotë se ata do të bëhen udhëheqës të njerëzve. Ata do të pasurohen dhe interesi i vetëm i tyre do të jetë gara në ndërtimin e ndërtesave të larta. Kjo është si në hadithin që do ta shohim më vonë: "Çasti s'do të vjen, derisa njerëzit më të lumtur në botë të jenë bijtë e prishur të të prishurve".

Qe transmetuar nga Ebu Se'id se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Çasti s'do të vjen, derisa të vjen koha kur një burrë do të dalë nga shtëpia e vet dhe këpucët apo kamxhiku i tij do të tregojë çka i ka ndodhur familjes së tij".  
[Ahmed]

Qe transmetuar nga Ebu Se'id se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, Çasti s'do të vjen, derisa kafshët e egra t'u flasin njerëzve, dhe njeriu t'i flasë kamxhikut të vet apo këpucës së vet, dhe shala e tij do t'i tregojë rreth familjes së tij mbasi ai ishte larguar prej tyre".

Enes tha: "Ne po diskutonim faktin që Çasti s'do të vjen, derisa të mos bjerë më shi, toka të mos prodhojë frytet e saj, dhe pesëdhjetë gra të mbahen nga një burrë, dhe, nëse një grua kalon pranë një burri, ai do ta shikojë e do të thotë: 'Kjo grua dikur kishte një burrë'". [Ahmed]

Ebu Hurejre tha se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Çasti s'do të vjen, derisa koha të kalojë aq shpejt, sa që një vit do të jetë si një muaj, një muaj si një javë, një javë si një ditë, një ditë si një çast, dhe një çast aq sa të digjet një fletë e drurit të palmës". [Ahmed]

Ebu Hurejre tha se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Bota s'do të mbarojë, derisa ai që kënaqet më së shumti në të, të jetë biri i prishur i të prishurit". [Ahmed]

Ebu Hurejre tha se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Para ardhjes së Çastit, do të ketë vite mashtrimi, gjatë të cilave besnikut s'do t'i zihet besë, kurse gënjeshtarit do t'i besohet, dhe të pavlerit do t'i shkojë fjala".  
[Ahmed]

Ebu Hurejre tha se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Çasti s'do të vjen, derisa dashi me brirë të mos e luftojë më dashin pa brirë".  
[Ahmed]

Ebu Hurejre tha se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Çasti s'do të vjen, derisa pasuria të shtohet aq shumë, sa që njeriu do të tutet se s'do të ketë kush ta pranojë sadakanë prej tij; derisa të shfaqen çrregullimet dhe të ketë shumë *herxh*". Të pranishmit pyetën: "Çka është *herxh*, o i Dërguar i Allahut?" Tha: "Vrasje! Vrasje!" [Ahmed]

Ebu Hurejre tha se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Pasha Atë që më dërgoi me të vërtetën, kjo tokë s'do të mbarojë, derisa njerëzit të dëmtohen nga një shkarje toke, njerëzve t'u bie rrebesht gurësh dhe të transformohen në kafshë". Të pranishmit pyetën: "Kur do të ndodhë kjo, o i Dërguar i Allahut?" Tha: "Kur të shihni femrën të kalërojë, kur këngëtarët të jenë dukuri e zakonshme, kur dëshmimi i rrejshëm të përhapet, dhe kur burri të flejë me burrë dhe gruaja me grua".

Tarik ibn Shihab tha: "Po rrinim ulur me Abdullah ibn Mes'ud, kur një burrë erdhi dhe na tha se kishte ardhur koha e namazit. Ne u çuam dhe shkuam në xhami. Mbas namazit, një burrë erdhi të Abdullah ibn Mes'udi dhe tha: '*es-Selam alejke*, o Ebu AbduRrahman'. 'Allahu dhe i Dërguari i tij e kanë thënë të vërtetën', ia kthehu Abdullahu. Kur u kthyem, pyetëm shoqi-shoqin: 'A dëgjuat si u përgjigj? Kush do të pyes rreth kësaj?' Thashë: 'Unë do ta pyes', dhe e pyeta kur ai doli dhe na e transmetoi këtë nga peygamberi:

"Para se të ndodhë Çasti, do të ketë një përshëndetje të posaçme për njerëzit, tregtia do të përhapet aq shumë, sa që një grua do t'i ndihmojë burrit të saj në biznes; lidhjet familjare do të ndërpriten; dëshmimi i rrejshëm do të jetë i zakonshëm, kurse dëshmitari i vërtetë vështirë do të gjendet; dhe do të shtohet të shkruarit". [Ahmed]

Përshkrimi i njerëzve që do ta përjetojnë ditën e Kiametit

Qe transmetuar nga Abdullah ibn Amr se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Çasti s'do të vjen, derisa Allahu të marrë njerëzit më të mirë në tokë dhe të mbeten më të këqijtë, të cilët s'do ta njohin të mirën dhe s'do të ndalojnë nga kurrfarë e keqe". [Ahmed]

Abdullah ibn Mes'ud tha se kishte dëgjuar peygamberin [salallahu alejhi ue selam] të thotë:

"Elokuenca mund të magjeps. Njerëzit më të këqij janë ata, që u vjen Çasti ndërsa janë të gjallë, dhe ata që i kthejnë varret në xhamia". [Ahmed]

Qe transmetuar nga Enes se peygamberi [salallahu alejhi ue selam] kishte thënë:

"Çasti s'do të vjen, derisa kurrkush mbi tokë të mos thotë 'la ilahe ilaAllah'".  
[Ahmed]

Po ashtu, nga Enes qe transmetuar se pejgamberi kishte thënë:

"Çasti s'do të vjen, derisa kurrkush në tokë të mos thotë 'Allah, Allah'". [Ahmed]

Ka dy mendime lidhur me shprehjen 'Allah. Allah':

1. Domethënia e kësaj mund të jetë se kurrkush s'do të ndalojë nga e keqja apo të mundohet ta përmirësojë ndonjë që bën keq. Tashmë këtë e kemi hasur në hadithin e Abdullah ibn Amr: " Do të mbeten më të këqijtë, të cilët s'do ta njohin të mirën dhe s'do të ndalojnë nga kurrfarë e keqe".
2. Domethënia e kësaj mund të jetë se Allahu s'do të përmendet dhe emri i Tij do të jetë i panjohur. Kjo do të ndodhë, për shkak të mbizotërimit të kufrit dhe prishjes, si në hadithin paraprak: "... derisa kurrkush në tokë të mos thotë 'Allah, Allah'". Aisha tha se pejgamberi kishte thënë: "Hyri pejgamberi duke thënë: 'Oj Aishe, familja jote do të jenë të parët nga Umeti im që do të më bashkohen". Kur ai u ul, thashë: "O i Dërguar i Allahut, u flijofsha për ty!, kur hyre, po thoshe diçka që më trembi. "Çka ashtu?" Thashë: "Ti the se familja ime do të jenë të parët që do të të bashkëngjiten". Ai tha: "Po". Pyeta: "Pse kështu?" Ai tha: "Vdekja do të përhapet midis tyre dhe të afërmit e tyre do t'i xhelozojnë". Thashë: "Si do të jenë njerëzit pas kësaj?" Tha: "Si karkalecat: i forti do ta përpijë të dobëtin, deri të vjen Çasti". [Ahmed]

Alba'el-Selami tha: "Dëgjova pejgamberin [salallahu alejhi ue selam] të thotë:

'Çasti do t'u vijë vetëm më të këqijve nga njerëzit'". [Ahmed]